

Durrës

RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT
STRATEGJIK MJEDISOR

DRAFT

FAZA 4 | RAPORTI PARAPRAK
VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR BASHKIA
DURRËS

1 | VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

1.1 Kuadri i referimit ligjor

- 1.1.1 Normativa evropiane
- 1.1.2 Normativa shqiptare

1.2 Integrimi i VSM-së në planifikimin territorial

2 | OBJEKTI I VLERËSIMIT

2.1 Profili i territorit

2.2 Konteksti i Durrësit

2.3 Objektivat e planit

- 2.3.1 Veprimet strategjike për sistemin urban
- 2.3.2 Veprimet strategjike për sistemin infrastrukturor
- 2.3.3 Veprimet strategjike për sistemin ujqor
- 2.3.4 Veprimet strategjike për sistemin natyror
- 2.3.5 Veprimet strategjike për sistemin bujqësor

2.4 Verifikimi i koherencës

- 2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar
- 2.4.2 Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin
- 2.4.3 Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës
- 2.4.4 Planet strategjike

3 | ASPEKTET METODOLOGJIKE

3.1 Leximi i territorit nëpërmjet treguesve

- 3.1.1 Treguesit e planit për verifikimin e koherencës
- 3.1.2 Modeli PPGNP për treguesit territorial
- 3.1.3 Vështirësi të hasura gjatë përgatitjes së raportit mjedisor

3.2 Vlerësimi i alternativave të planit

3.3 Alternativat

3.4 Analiza SWAT

4 | OBJEKTIVAT E MBROJTJES MJEDISORE

5 | KARAKTERISTIKAT MJEDISORE DHE TERRITORIALE TË DURRËSIT

5.1 Ajri

5.2 Uji

- 5.2.1 Ujërat sipërfaqësor
- 5.2.2 Ujërat nëntokësor
- 5.2.3 Ujërat bregdetare
- 5.2.4 Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza

5.3 Toka

- 5.3.1 Vulnerabiliteti ndaj erozionit
- 5.3.2 Zonat e ndotura

5.4 Biodiversiteti

- 5.4.1 Zona të mbrojtura
- 5.4.2 Pyjet

5.5 Mbetjet urbane

6 | VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË PLANIT

7 | MONITORIMI I PLANIT

7.1 Sektori i ajrit

7.2 Sektori i ujit

7.3 Sektori i transportit

7.4 Sektori i biodiversitetit

7.5 Sektori i sistemit të zbatimit

8 | KONSULTIMI ME PALET E INTERESUARA

Treguesit e tabelave

Tabela 4.1 Identifikimi i objekteve të qëndrueshmërisë mjedisore dhe prioritetet

Tabela 4.2 Matrica finale e krahasimit të objektivave kryesorë specifik të planit të Durrësit me kriteret e përgjithshëm për realizimin e tij

Tabela 5.1 Të dhëna për cilësinë e ajrit të Durrësit

Tabela 5.2 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve në Durrës

Tabela 5.3 Tipologjitë e mbetjeve urbane - bashkia e re Durrës

Tabela 6.1 Matrica e vlerësimit të efekteve të masave të veprimit të planit

Tabela 7.1 Legjenda përfaqësuese e indikatorëve nëpërmjet ikonave të Cerchoff

Tabela 7.2 Indikatorit për monitorimin e cilësisë së sektorit të ajrit

Tabela 7.3 Indikatorit për monitorimin e cilësisë së sektorit të ujit

Tabela 7.4 Indikatorit për monitorimin e cilësisë së sektorit të transportit

Tabela 7.5 Indikatorit për monitorimin e cilësisë së sektorit të biodiversitetit

Tabela 7.6 Indikatorët e verifikimit të ndikimeve në mjedis të masave vepruese të planit në sektorin e sistemit të zbatimit

Treguesit e tabelave

Figura 1.1 Fazat procedurale të VSM

Figura 2.1 Territori i Durrësit, Shijakut dhe Vorës

Figura 2.2 Territori i Durrësit, objekt analize

Figura 5.1 Harta e shfrytëzimit të territorit 1930 - 2015

Figura 5.2 Kanal kullimi në zonën e Kënetës, Durrës

Figura 5.3 Ndotja e ujit në rajonin Durrës - Tiranë

Figura 5.4 Hartat e shpërndarjes së joneve të Cl në zonën e Tiranë - Durrës për periudhën a) 1982 - 2001 b) 2010

Figura 5.5 Hartat e shpërndarjes së joneve të Na dhe joneve + K në zonën e Tiranë-Durrës për periudhën a) K 2010 b) Na 2010 c) Na+K 1982 - 2001

Figura 5.6 Harta e shpërndarjes së TDS për zonën Tiranë-Durrës për periudhën a) 1982-2001 b) 2010

Figura 5.7 Ndotja e bregdetit të Durrësit

- Figura 5.8 Impianti i ri i pastrimit të ujërave të zeza në Durrës
- Figura 5.9 Niveli i erozionit në rajonin Durrës-Tiranë
- Figura 5.10 Erozioni bregdetar përgjatë gjirit të Lalzit
- Figura 5.11 Erozioni bregdetar i Gjirit të Lalzit, në afërsi të grykderdhjes së lumit Erzen
- Figura 5.12 Harta e vulnerabilitetit ndaj erozionit në Gjirin e Lalzit sipas metodës së propozuar nga Bosom & Jimenez (2011)
- Figura 5.13 Harta e vulnerabilitetit ndaj përmytjeve në Gjirin e Lalzit sipas metodës së propozuar nga Bosom & Jimenez (2011)
- Figura 5.14 Rrënojat e impiantit kimik të vjetër në Porto Romano
- Figura 5.15 Terren i ndotur me përmbajtje squfuri dhe kripëra kromi afër një stabilimetri kimik të mbyllur, Porto Romano (Durrës)
- Figura 5.16 Kontenier për ruajtjen e substancave kimike toksike të lëna në zonën e magazinimit të Porto Romano
- Figura 5.17 Impianti kimik i braktisur në zonën e Porto Romanos
- Figura 5.18 Zona e re për ruajtjen e hidrokarbureve dhe GPL në Porto Romano
- Figura 5.19 Zona të mbrojtura dhe natyrale në Shqipëri
- Figura 5.20 Vendet më të prekshme nga ndryshimet klimaterike
- Figura 5.21 Zona ekzistuese të mbrojtura nga Strategjia e Biodiversitetit Shqiptar dhe Plani i Veprimit (2000)
- Figura 5.22 Zonat e Propozuara për Mbrojtjen nga Strategjia e Biodiversitetit Shqiptar dhe Plani I Veprimit (2000)
- Figura 5.23 Harta e Pyjeve shqiptare me tregues të nivelit të dëmtimit
- Figura 5.24 Mbetje të braktisura përgjatë një rruge në afërsi të një kanali në Durrës
- Figura 5.25 Rrugë përgjatë Porto Romanos e rrethuar nga mbetje
- Figura 5.26 Shkarja e një grumbulli mbeturinash përgjatë Lumit Erzen në afërsi të vendshkarkimit të Sharrës

1 Vlerësimi strategjik mjedisor

Rrugëtimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në nivel ndërkombëtar nisët nga larg dhe zhvillimi i tij metodologjik dhe operativ mund të gjendet në manualistikën e shumtë mjedisore, të pranishme si në shtetet e Bashkimit Evropian ashtu edhe në eksperiencat amerikano-veriore, duke ndjekur parametra disiplinore të lidhura me tema të kulturës mjedisore, që më pas evoluon në kërkimin e hipotezave të zhvillimit të qëndrueshëm, deri në kuptimin e aspekteve të lidhura me pjesëmarrjen në procese vendimmarrëse.

Duke filluar nga vitet '90, në disa vende evropiane ka filluar të ndjehet nevoja për të zhvilluar instrumente që do të mundësojnë integrimin e aspekteve mjedisore në proceset e planifikimit territorial dhe urban. Përballë një situatë territoriale të ndikuar nga periudha zhvillimi intensiv të vendbanimit dhe prodhimit, që në dekadat e mëparshme u manifestua me një përdorim të rëndësishëm të tokës, mund të ndjehej rëndësia dhe nevoja për të përcaktuar strategji të mprehta për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe peizazhistike, duke u përpjekur për ta rritur atë si një burim brenda politikave të planifikimit.

Nevojat e shfaqura në dy dekadat e fundit në fushën e planifikimit mund të përmbledhen në pikat e mëposhtme:

- një konsideratë më e madhe e kontekstit dhe e ndryshorëve mjedisor në përkufizimin e ndërhyrjeve të reja, tenton ta shtyjë sistemin përtej atyre vlerave prag, për të cilat ndikimet në mjedis mund të bëhen të dëmshme;
- perceptimi i instancave që vijnë nga popullsia vendase dhe nga subjektet mbartës të interesave, duke përfshirë më së shumti opinionin publik në vendimet më të rëndësishme;
- realizimi i pikave të sipërpërmendura në mënyrë të qëllimshme, duke i integruar në procesin e planifikimit si inpute shtesë në gjendje të përmirësojnë planin urbanistik, duke kualifikuar një instrument të aftë për të kombinuar kërkesat e zhvillimit me ato të mbrojtjes dhe të arrijë si rrjedhim një zhvillim të qëndrueshëm të ndarë dhe që zgjat të territorit.

Vlerësimi strategjik mjedisor përfaqëson, në këtë kuptim, instrumentin për përfshirjen e aspekteve të parashtruara më sipër në kuadrin e planifikimit urban, siç është njohur nga Komuniteti Evropian, i cili e ka prezantuar VSM-në me Direktivën 2001/42/CE.

Proçedura VSM ka karakteristikën t' bashkëngjitet procesit të planit, duke e shoqëruar përgjatë gjithë procesit të tij projektues dhe administrativ, me qëllimin për të ndërhyrë në mënyrë organike në zhvillimin e strategjive territoriale, së fundi duke përpunuar një kuadër të zhvillimit të përputhshëm me mjedisin. VSM ka meritën e integritit në procesin e vlerësimit, përkrahë me aspektet mjedisore dhe atyre ekonomike e sociale, duke promovuar qëndrueshmërinë e zhvillimit në fushën e planifikimit.

Duke nisur nga 2013, edhe Shqipëria ka paraqitur me Ligjin nr. 91/2013 Vlerësimin Strategjik Mjedisor në brendësi të legjisllacionit të saj, duke e aplikuar dhe integruar në praktikën e planifikimit.

1.1 Kuadri i referimit ligjor

1.1.1 Normativa evropiane

Direktiva Evropiane 2001/42/CE në lidhje me vlerësimin e ndikimeve të planeve dhe programeve të caktuar në mjedisin natyror, e ashtuquajtura Direktiva VSM, e vënë në fuqi më 21/7/2001, vendos si objektiv garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe identifikon, në vlerësimin strategjik mjedisor, instrumentin për integrimin e konsideratave mjedisore në aktin e përpunimit dhe të adoptimit të planeve dhe programeve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, siguron që efektet mjedisore, që rrjedhin nga zbatimi i planeve dhe programeve të caktuara (art. 3), të merren në konsideratë dhe të vlerësohen gjatë përpunimit dhe para adoptimit të tyre. Vlerësimi Strategjik Mjedisor përkufizohet kështu si një proces sistematik për të vlerësuar pasojat në nivel mjedisor të veprimeve të propozuara – politikave, planeve apo iniciativave në fushën e programeve kombëtare, rajonale dhe vendore – në mënyrë që këto të jenë të përfshira dhe të trajtuara njësoj me konsideratat me natyrë ekonomike dhe sociale, që nga fazat e para (strategjike) të procesit të vendimmarrjes. VSM përmbush kështu detyrën e verifikimit të koherencës së propozimeve programatike dhe planifikuese me objektivat e qëndrueshmërisë, ndryshe nga Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) që aplikohet në projekte të veçantë veprash (objektesh).

Përpunimi i procedurave të përcaktuara në Direktivën 2001/42/CE, e cila duhet të ishte njohur nga Shtetet Anëtare brenda 2004, përfaqëson një instrument mbështetës, si për propozuesin ashtu edhe për vendimmarrësin, për krijimin e adresave dhe zgjedhjeve të planifikimit, duke siguruar mundësi alternative krahasur me arritjen e një objekti nëpërmjet përcaktimit të ndikimeve të mundshme të veprimeve të propozuara. Në thelb, VSM bëhet për Planin/Programin (PP) një instrument: konstruktiv; vlerësues; menaxhues; monitorues.

Funksioni i monitorimit përfaqëson një nga aspektet inovativ të prezantuar në Direktivë, i finalizuar për të kontrolluar dhe kundërshtuar efektet negative të parashikuar, që janë si rezultat i zbatimit të një plani apo programi, dhe për të adoptuar masa korrigjuese për procesin në zhvillim.

Ndër ndryshimet e tjera të paraqitura nga Direktiva theksohet:

- kriteri i gjerë i pjesëmarrjes, mbrojtja e interesave legjitime dhe transparencë në procesin vendimmarrës që ndodh nëpërmjet përfshirjes dhe konsultimit në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit të autoriteteve “që sipas përgjegjësive të tyre specifike mjedisore, ka të ngjarë të jenë të interesuara për efektet mjedisore si rezultat i zbatimit të planeve dhe programeve” dhe të publikut, që në njëfarë mënyre është i interesuar për vendimet;
- konsultimet ndërkuftare me Vendet e Botës së Tretë, nëse konsiderohet se zbatimi i një plani apo programi në fazë përgatitore mund të ketë efekte të rëndësishme ndërkuftare.

Vlerësimi mjedisor “bëhet gjatë fazës përgatitore të planit ose programit dhe para miratimit të tij apo nisjes së procedurës legjislative relative” (art. 4, paragrafi 1) dhe udhëheq redaktimin e “një raporti mjedisor në të cilin janë përcaktuar, përshkruar dhe vlerësuar efektet domethënëse që mund të sjellë zbatimi i planit apo programit mbi mjedisin, pavarësisht alternativave të arsyeshme në dritën e objektivit dhe në fushën territoriale të planit apo programit” (art. 5, paragrafi 1).

Informacionet e kërkuara për redaktimin e një raporti të tillë janë specifikuar në Shtojcën I të direktivës. Propozimi i planit apo programit dhe raporti mjedisor janë vënë në dispozicion të autoriteteve kompetente dhe sektoreve të publikut të prekur nga procesi i vendimmarrjes (hartuar nga Shtete anëtare) (art. 6).

Janë subjekt i VSM-së planet dhe programet e sektorëve që përbëjnë kuadrin e referimit për autorizimin e projekteve të listuar në Shtojcën I dhe II të Direktivës 337/85/CEE dhe të gjithë planet dhe programet për të cilët është parashikuar vlerësimi i listuar sipas Direktivës 92/43/CEE, në qoftë se prodhojnë efekte domethënëse.

Janë përjashtuar nga fusha e aplikimit të direktivës planet dhe programet në varësi të qëllimit të mbrojtjes kombëtare, mbrojtjes civile, finiciare ose të bilancit, ose ata të financuar nga Regg. 1260/1999/CE, 1257/1999/CE.

1.1.2 Normativa shqiptare

Sipas Ligjit të Shqipërisë nr.91/2003 në lidhje me VSM-në, procesi i vlerësimit strategjik mjedisor artikullohet në stadet që vijojnë më poshtë:

- a. njoftimi i Ministrisë nga autoriteti propozues;
- b. konsultimi me palët e interesuara për çështjet që duhet të përballen në raportin mjedisor;
- c. redaktimi i raportit paraprak dhe konsultimi me palët e interesuara dhe publikun në lidhje me të;
- d. redaktimi i raportit final të Vlerësimit Strategjik Mjedisor;
- e. verifikimi i relacionit dhe deklaratës së Ministrit;
- f. vendimi i autoritetit miratues;
- g. monitorimi dhe sinjalizimi i ndikimeve mjedisore të planit apo programit.

Objekti i VSM-së është të përcaktojë, të përshkruaj dhe vlerësojë të gjitha ndikimet negative domethënëse në mjedis, që mund të vinin nga zbatimi i planit apo programit, dhe sigurimi i një alternative më të favorshme nga perspektiva mjedisore.

Raporti i VSM-së duhet të përfshijë edhe masat që do të adoptohen për të evituar dhe



lehtësuar ndikimet negative që vijnë nga zbatimi i planit apo programit.

Metodologjia për redaktimin e raportit të VSM-së duhet të jetë konform Ligjit nr. 91/2013 që rrjedh nga Direktiva BE 2001/42/CE, që lidhet me vlerësimin e ndikimit të planeve dhe programeve të caktuara në mjedisin natyror.

Në bazë të normativës shqiptare (art. 10), raporti i VSM-së duhet të përfshijë aspektet e mëposhtme:

- a. një sintezë të përfundimeve dhe të objektivave parësore të planit apo programit dhe përputhja e saj me plane dhe programe të tjerë që lidhen me të;
- b. një përshkrim të metodologjisë së përdorur për redaktimin e raportit të VSM-së, përfshirë vështirësitë e hasura gjatë përgatitjes së tij dhe burimet e informacionit që janë përdorur për redaktimin e relacionit;
- c. një sintezë të alternativave të marra në konsideratë gjatë përgatitjes së planit apo programit, përfshirë “alternativën zero” dhe arsyet e zgjedhjes;
- d. një sintezë të objektivave të mbrojtjes mjedisore në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal ose vendor, që u referohen planeve dhe programeve dhe mënyrës sipas të cilës këta objektiva merren në konsideratë gjatë përgatitjes së propozimit;
- e. një përshkrim i karakteristikave mjedisore në fushën e zhvillimit të planit apo programit;
- f. një sintezë të elementeve pozitive mjedisore në zonat që mund të ndikohen në mënyrë domethënëse nga plani apo programi;
- g. një përshkrim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis, në biodiversitet, në shëndetin publik, në tokën natyrale, në klimë, në ajër, në ujë, në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, në peizazh dhe në ndërveprimin midis këtyre faktorëve;
- h. impaktet e mundshme negative ndërkufitare, nëse janë të pranishëm;
- i. një sintezë të masave të parashikuara për të evituar, pakësuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis gjatë zbatimit të planit apo programit;
- j. përcaktimin e investimeve apo të veprave të mbrojtjes mjedisore, të cilësuar si të nevojshme në fushën e zbatimit të planit apo programit të propozuar;
- k. një përshkrim të masave të parashikuara për të monitoruar ndikimet gjatë zbatimit të propozimit;
- l. një përmbledhje jo teknike të informacioneve të transmetuara.

(në faqen paraardhëse)
Figura 1.1
Fazat
procedurale të
VSM-së

Në nivel proçedural, fazat e procesit të VSM-së janë ilustruar në vijim.

Shënim	Hapat	Objektivi kryesor
I detyrueshëm	Verifikimi	Të përcaktohet nëse VSM-ja është e nevojshme
I detyrueshëm	Studimi	Të përcaktohet fusha e studimit
I detyrueshëm	Përgatitja e raportit mjedisor	Alternativa të arsyeshme; identifikim, përshkrim dhe vlerësim i ndikimeve negative në mjedis
I detyrueshëm	Konsultimi	Konsultimi me aktorët kryesor dhe publikun për tri hapat e përmendura më sipër
I detyrueshëm	Vendimmarrja	Me të parë përfundimet; deklarata përmbledhëse
I detyrueshëm	Monitorimi	Monitorimi i ndikimeve negative në mjedis

1.2 Integrimi i VSM-së në planifikimin territorial

Nga fillimi i viteve shatëtdhjetë filloi të bëhet e pranishme, për opinionin publik të vendeve të industrilizuara, një ndjeshmëri gjithnjë e më shumë në rritje për çështjet mjedisore dhe një ndërgjegjësim në lidhje me pasojat e provokuara nga një model zhvillimi që deri atëherë e konsideronte cilësinë e mjedisit dytësore krahasuar me objektivat e zhvillimit.

Përgjatë viteve, kanë qenë të shumta metodat e zhvilluara për përfshirjen e marrjes në konsideratë të dimensionit mjedisor në proceset vendimmarrëse, që mund të përcaktonin ndërhyrje me ndikime të mundshme negative në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, dhe eksperiencat e grumbulluara në këtë fushë kanë kontribuar në përcaktimin e teknikave të vlerësimit mjedisor nëpërmjet rrugëve gjithmonë e më të rafinuara.

Edhe disiplina urbanistike është përfshirë në këtë proces dhe ka lindur nevoja e një thellimi si teorik ashtu edhe teknik për temën në fjalë. Duke filluar nga vitet 80' fillon të përhapet një shumëllojshmëri normativash me karakter mjedisor në nivel evropian që, në mënyrë indirekte, ndikojnë disiplinën planifikuese, por që për shumë kohë nuk ishin perceptuar.

Lind kështu, në vende të ndryshme, nevoja për të përshtatur normativat përkatëse, duke vënë në zbatim instrumentet ligjore që janë në gjendje të përballojnë në mënyrë të qartë dhe efikase problematikat e lidhura me mjedisin. Me përhapjen, në 2001, të Direktivës

2001/42/CE, e ashtuquajtur direktiva “VSM”, hapet një fazë që i sheh shtet anëtare të përfshira në zbatimin e proçedurave, metodologjive dhe teknikave për vlerësimin e projekteve, programeve dhe planeve nga një këndvështrim mjedisor.

Përhapja e direktivës ka sjellë një seri risish në fushën e urbanistikës, sepse ajo favorizon kapërcimin përfundimtar të ndarjes, në disiplinën urbanistike, midis analizës dhe projektimit dhe tenton të përmirësojë projektin urbanistik nëpërmjet vlerësimit paraprak të ndikimeve negative mjedisore.

VSM është zhvilluar duke u nisur nga eksperiencat e grumbulluara nga zbatimi i Direktivës 85/33/CE në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve të caktuara (VNM). VNM-ja ishte një nga proçedurat e para të vlerësimit mjedisor të parashikuara nga legjislacioni evropian, duke hapur rrugën e normativave të mëtejshme që kanë prekur tej për tej të gjithë sektorët, nga bujqësia tek industria; edhe sot ky instrument i vetëm nuk është në gjendje të promovojë një model të zhvillimit të qëndrueshëm territorial. Vlerësimi në shkallë projektesh të veçantë, përkundrazi, nuk e lejon këtë tip analize në nivel sistematik, që lejon të marrë strukturën e ndërlikuar të marrëdhënieve midis sistemit antropik dhe atij mjedisor, dhe kështu të parashikojë ndikimet e mundshme në mjedis. Kufizim tjetër i VNM-së rrjedh nga fusha e ngushtë e veprimit të tij, që e bën proçedurën të paafte për të vepruar në efektet grumbullues, sinergjik dhe indirekt të aktivitetit projektues.

Si rrjedhojë, vëmendja është përqendruar në përcaktimin e një tipi të ri të vlerësimit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor që, duke u unifikuar me parimet dhe me filozofinë në bazament të VNM-së (informacioni, pjesëmarrja, konsultimi) dhe shfrytëzimin e eksperiencës praktike të fituar, arrin në të njëjtën kohë të adaptohet me një instrument më elastik, të aftë të integrohet në fazën më të ndërlikuar të programimit. VSM, në fakt, vendoset në krye të procesit vendimmarrës, duket marrë në konsideratë faktin që është ky nivel në të cilin merren vendimet e mundshme për të ndikuar në kontekstin mjedisor. VSM bazohet në konsiderimin se vlerësimi mjedisor duhet të bëhet në një fazë paraprake të ndryshimeve mjedisore, të gjeneruara nga ndryshimet territoriale të parashikuara nga projekti apo plani dhe duhet të jetë një proces “në ndihmë të vendimmarrjes”. Në këtë mënyrë jemi dëshmitarë të një hapi të mëtejshëm përpara në miratimin e konceptit modern të vlerësimit mjedisor, që kthehet kështu në një përmbledhje të fazave vlerësuese që bëhen pjesë e procesit të vendimmarrjes, pa u konsumuar në një stad, por duke e shoqëruar në çdo moment të tij.

VSM është një mbështetje e vlefshme për planifikimin pasi është një instrument, që ndihmon procesin vendimmarrës duke përfituar nga objektivat dhe kriteret që përcaktohen ose ndahen *a priori* dhe që janë baza për identifikimin e strategjive të ndërhyrjeve. Një nga objektivat kyç të zhvillimit të qëndrueshëm, në fakt, është e lidhur me krijimin e proceseve pjesëmarrëse, pasi tashmë është e qartë që nuk mund të ekzistojë një zhvillim i qëndrueshëm nëse ai nuk gjen në komunitetin lokal një nivel të lartë të ndarjes. VSM prezantohet edhe si një stimul i vlefshëm për projektimin, sepse lejon të identifikohet idea forcë e përshtatshme për territorin dhe veprimet projektuese të për-

shtatshme, dhe për më tepër parashikon veçanërisht marrjen në konsideratë të alternativave të arsyeshme. Së fundi e bën monitorimin efikas, falë gamës së pasur të treguesve të referencës që verifikojnë arritjen reale të objektivave të programuar dhe identifikojnë me shpejtësi ndikimet mjedisore të parashikuara, duke lejuar adoptimin e masave korrigjuese dhe një përmirësim të vazhdueshëm të procesit nëpërmjet skemave të kontrollit. Për një aplikim korrekt, procesi i VSM duhet të ndahet në tri momente të ndryshme:

- ish-para: para redaktimit të planit apo programit, në mënyrë që të vihen në dukje problemet mjedisore;
- në vazhdim: gjatë redaktimit të planit, duke marrë në konsideratë ndikimet e mundshme të ndërhyrjeve, duke vlerësuar koherencën me vlerësimin ish-para, rëndësia e objektivave dhe shkalla e arritjes së tyre; në këtë fazë, procesi i vlerësimit dhe ai i redaktimit të planit duhet të realizohen paralelisht në mënyrë që të përballojnë problematikat bashkarisht;
- ish-pas: pasi të jetë realizuar, plani tregon përfshirjen e burimeve, efikasitetin e ndërhyrjeve, ndikimin e tyre dhe koherencën me vlerësimin e ish-para; pas miratimit vendoset se cilët tregues duhet t'i nënshtrohen monitorimit të përhershëm për të verifikuar nëse zgjedhjet e planit janë të qëndrueshme.

Së fundi, për të koordinuar procesin e formimit të Planit Territorial të Durrësit, Shijakut dhe Vorës me procesin e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM), fazat e ndryshme të proceseve respektive janë koordinuar mes tyre:

- faza fillestare e përpunimit të planit ka parashikuar një analizë të parë, megjithëse me karakter të përgjithshëm dhe me kontekst kompleks, mbi gjendjen e mjedisit dhe mbi sistemin e programimit;
- përpunimi i planit ka përkuar me përpunimin e **“raportit mjedisor paraprak”** dhe analizat kanë përdorur të njëjtin kuadër njohës;
- kundra-deduktimet e planit do të përkojnë me miratimin e **“raportit mjedisor final”** dhe kështu me përfundimin e procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

2 Objekti i vlerësimit

2.1 Profili i territorit

Territori i Durrësit, Shijakut dhe Vorës përbën një rajon të madh që sheh Adriatikon, me 65 km vijë bregdetare, dhe zgjerohet për rreth 20 km drejt brendësisë.

Territori i Durrësit, Shijakut dhe Vorës zë një pozicion strategjik në brendësi të Shqipërisë: gjendet në qendër të vendit, në afërsi të ngushtë me kryeqytetin Tirana dhe është pozicionuar përgjatë bregut adriatik. Territori Durrës, Shijak dhe Vorë mund të konsiderohet porta hyrëse e Shqipërisë si nga toka ashtu edhe nga deti.

Në mënyrë që të kufizohet territori i Durrësit, Shijakut dhe Vorës, rezulton i nevojshëm vëzhgimi në tërësi i territorit shqiptar (Figura 2.1). Peizazhi i Shqipërisë mund të konceptohet si një sekuenca zinxhirësh malor, drejtimi i të cilëve është paralel me bregdetin. Ndërkohë që, drejt brendësisë, malet mbulojnë tërësinë e territorit, drejt bregdetit, transformohen në kodra. Alternimi ndërmjet fushave dhe maleve/kodrave i jep territorit një anatomi të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme. Relievi malor/kodrinator përfaqëson edhe një barrierë natyrore që, deri tani, ka bërë të mundur pengimin e procesit të urbanizimit të pakontrolluar.

Pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria vendoset në një pozitë të dukshme përkrahjeje ekonomike dhe kulturore. Afrimi hap pas hapi me Evropën, që arrin kulmin me kërkesën për të bërë pjesë në Bashkimin Evropian në 2009, dhe nxitja që iu dha ekonomisë nga qeveria nëpërmjet politikave të miratuara për t'i dhënë qëndrueshmëri vendit, ka lejuar një rritje të shpejtë ekonomike me një rritje vjetore të PBB-së prej mbi 6% mesatarisht ndërmjet vitit 2000 dhe 2009, i ngadalësuar vetëm në vitet e fundit për shkak të krizës ekonomike globale. Sektorët kryesorë janë ata të artizanatit, bujqësisë, energjisë dhe turizmit që mbajnë një trend pozitiv rritjeje vjetore prej 3%.

Në këtë fazë të zhvillimit të shpejtë është e pashmangshme mungesa e vëmendjes ndaj mjedisit. E shfrytëzuar prej vitesh, pa ndjekur praktikën e mbrojtjes dhe ruajtjes, ka risjellë pasoja të rënda negative, shpesh të pakthyeshme, si humbja e biodiversitetit, shfytëzimi i burimeve natyrore, rritja e ndotjes, urbanizimi pa kriter në mungesë të planifikimit dhe shpesh abuziv. Mungesa e stimuljeve ekonomik për mbrojtjen e mjedisit dhe mungesa e një sistemi vëzhgues të përshtatshëm, përveç të tjerash, ka përkeqësuar problematikat mjedisore të vendit.

Qëndrueshmëria e zhvillimit tashmë përfaqëson një objektiv strategjik dhe jo më të lënë pas dore për Shqipërinë, që duhet të vlerësojë trashëgiminë e vetë mjedisore dhe peizazhistike, shumë të dëmtuar, dhe të përballet me kritikën aktuale mjedisore që kryesisht i atribuohen një menaxhimi të keq të burimeve dhe një aktiviteti ndërtimor të dhunshëm dhe të pakontrolluar.

Pavarësisht shfrytëzimit të burimeve natyrore të viteve të fundit, Shqipëria vazhdon të paraqesë një pasuri impresionuese duke marrë parasysh përmasat e saj të vogla: pyjet përfaqësojnë rreth një të katërtën e territorit, ka një potencial të madh për energjitë e ripërtëritshme dhe për industrinë e peshkut dhe një pasuri lumenjsh e rrjedhash. Gjithashtu ka burime minerale metalike (bakër, krom) në veri-lindje dhe në rajonet





Figura 2.1
Territori i
Durrësit,
Shijakut dhe
Vorës



(në faqen paraardhëse)
Figura 2.2
Territori i Durrësit objekt analize

malore qendrore, ndërkohë që në pjesën jug-perëndimore të vendit janë të pranishëm burime të konsiderueshme të naftës dhe gazit natyror.

Vendit nuk i mungojnë as bukuritë natyrore: ndodhen edhe pikat e shpallura trashëgimi botërore nga UNESCO, si parku arkeologjik i Butrintit dhe qendra historike e Gjirokastrës, peizazhet malore dhe rrjeti prej 15 hapësirash të mbrojtura, janë të pasura me shtigje natyrore kryesisht të panjohura për turizmin masiv.

Konteksti i Durrësit

2.2

Durrësi është një zonë urbane me një rritje të ndjeshme demografike, si dhe nga afërsia e tij me Tiranën ka një rol mjaft të rëndësishëm në rajon. Qyteti është në stadin e vështirë të identifikimit të rolit të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, pasi ai është ende një nga qytet-portet më të rëndësishme të Adriatikut dhe pararojë për një zonë të ardhme metropolitane.

Ky rol strategjik e vendos atë në pozicionin e favorshëm të vëzhguesit për fatin e kontekstit rajonal dhe ekstra-rajonar në të cilin ndodhen qytetet e Shqipërisë post-Hoxha.

Si dëshmi e rëndësisë strategjike të qytetit, është dhe ajo që ka dal nga regjistri i censurit të kryer në periudhat 2001-2011, Durrësi ka pasur një rritje të popullsisë urbane prej 49,9% dhe një rënie të popullsisë rurale me 41%. Në prefekturën e Durrësit (*Qarkun*) numri i banorëve është rritur me 9% për shkak të migrimit të brendshëm. Për sa i përket shpërndarjes së popullsisë, 75% është e përqendruar në qytet dhe vetëm pjesa tjetër e mbetur në zonat rurale, duke ndihmuar kështu në rritjen e fenomenit të urbanizimit që ka ndodhur në dekadën e fundit. Këto fenomene janë shoqëruar me një rritje të aktivitetit të ndërtimit me 62% në krahasim me vitin 2001, numra që përshkruajnë më së miri përmasat e zhvillimit të plotë të qytetit dhe rrethinat e tij.

Objektivat e planit

2.3

Vizioni strategjik për Durrësin bazohet në mundësinë e intensifikimit të zhvillimit urban, duke ruajtur trashëgiminë dhe resurset natyrore, të cilat kjo bashki i ka me bollëk. Durrësi është i përbërë nga elementë të mirëpacaktuar dhe lehtësisht të identifikueshëm, siç është porti, qendra historike, zona rezidenciale përreth stadiumit, zona rezidenciale përgjatë pjesës jugore të rivierës dhe vendbanimet e Kënetës e Spitallës. Ndërkohë që këto pjesë të qytetit identifikohen lehtësisht, bashkë me rrethinat e tyre dhe me zonat joformale, ju mungon akoma një përcaktim i mirëfilltë. Vizioni i propozuar në plan konsiston në dhënien e qytetit e një strukture që është lehtësisht e lexueshme në çdo pjesë të saj, duke përforcuar identitetin urban dhe duke shmangur një shtrirje të mëtejshme të ndërtimeve në drejtim të zonave bujqësore përreth. Duke parë se qyteti paraqet shumë hapësira të lira dhe një numër të lartë ndërtesash të pashfrytëzuara, propozohet

një vendosje urbane që konsiston në shfrytëzimin e hapësirave boshe dhe rikuperimin e strukturave të papërfunduara. Plani parashikon një seri masash vepruese strategjike, si hapja graduale e portit ndaj publikut dhe zhvendosja e portit industrial në Porto Romano, restaurimi i trashëgimisë kryesore historike, siç është kështjella dhe amfiteatri antik, ndërtimi dhe rikuperimi i strukturave të vjetra publike si shkolla, kopshte, parqe lojrash dhe hapësira publike.

Objektivat strategjik të identifikuar nga plani territorial për Durrësin janë:

1. Ristrukturimi dhe rehabilitimi i qendrave urbane dhe rurale;
2. Vlerësimi dhe ruajtja i monumenteve të trashëgimisë kulturore;
3. Garantimi i aksesit në shërbimet sociale dhe kolektive;
4. Përbushja e nevojave për banesa dhe përmirësimi i ofertave për strehim;
5. Implementimi i poleve të reja ekonomike, tregtare dhe zonave të prodhimit;
6. Përmirësimi dhe implementimi i infrastrukturave bazë urbane;
7. Përforsimi i rrjetit të transportit publik dhe i qarkullimit të ngadaltë;
8. Përmirësimi i transportit në rrugë;
9. Përcaktim i ri i portit;
10. Zgjidhja e problematikave kryesore mjedisore siç është erozioni, shkarjet e tokës dhe përmbytjet;
11. Vlerësimi dhe ruajtja e elementëve cilësor mjedisor.
12. Përmirësimi i agrikulturës duke qenë aktiviteti kryesor ekonomik i territorit;
13. Implementimi i sistemit të parqeve territoriale.

Masat vepruese korresponduese me objektivat të lartpërmendura janë të shtjelluara në vijim për secilin sektor që do ndërhyhet (sistemi urban, infrastrukturor, resurset hidrike, natyra dhe agrikultura).

Veprimet strategjike për sistemin urban

2.3.1

Ruajtja dhe rikuperimi i qendrave urbane dhe e trashëgimisë kulturore

Në qytetin e Durrësit, kjo strategji është e përcaktuar në mënyrë specifike nëpërmjet dy masave vepruese kryesore. E para i përket rehabilitimit dhe realizimi i zonave të hapura dhe publike në qendrën e qytetit, kurse e dyta i përket ruajtjes së objekteve historike dhe

rrënojave antike rurale. Në rastin e parë masat vepruese kanë për qëllim të rikuperojnë disa rrugë qendrore dhe hapësirat publike si dhe xjerrjen në pah të zonës së kështjellës, e njohur për potencialin e saj turistik. Në rastin e dytë, masat vepruese synojnë në rikuperimin e vlerave arkeologjike të Durrësit (si amfiteatri romak), kurse në zonat rurale ruajtja e fshatrave të vjetër dhe rrënojave antike, që janë veçanërisht të përqëndruara në zonën kodrinore të pjesës veriore të territorit komunal.

Këto masa vepruese janë tejet të rëndësishme për të arritur tjetërsimin e Durrësit jo vetëm në një destinacion për plazh gjatë stinës së verës, por edhe një pol tërheqës në sektorin e turizmit kulturor.

Realizimi i strukturave të reja kolektive

Kjo strategji synon në përmirësimin të nivelit të strukturave publike si në qytetin e Durrësit ashtu edhe në zonat rurale / fshatra të territorit të bashkisë. Si rrjedhojë e dëgjësive publike të zhvilluara, strategjia u përqëndrua në veçanti në realizimin e strukturave të dedikuara për edukimin, sportin dhe aktivitetet social-kulturore. Në veçanti masat vepruese do të aplikohen për:

- rindërtimi e shkollave ekzistuese dhe ndërtimi i shkollave të reja, kopshteve aty ku do të jetë e nevojshme, siç është zona e Kënetës ose Katund i Ri;
- rindërtimi i oborrit të shkollës ekzistuese duke e transformuar atë në një park lojrash funksional edhe për aktivitete sportive në mënyrë që të shfrytëzohet si nga nxënësit e shkollës ashtu edhe nga komuniteti jashtë orareve shkollore;
- realizimi i kopshteve të vegjël, oborre apo sheshe nëpër fshatra rurale, ku për momentin nuk gjenden asnjë hapësirë për takime dhe mbledhje;
- ndërtimi i qendrave social-kulturore, të projektuara si struktura të thjeshta polifunksionale për evente kulturore, të pajisura me biblioteka, salla konferencash, hapësira për projektim kinematografik, etj.

Realizimi i banesave të reja sociale

Kjo strategji synon të përmirësojë kapacitetin e ofertës së bashkisë në mënyrë që të përbushë kërkesat e qytetarëve, nëpërmjet rikuperimit të objekteve të papërfunduara, duke i destinuar në programin e shtëpive sociale, gjithashtu edhe dendësimi dhe konsolidimi i zonave të populluara në qytet në mënyrë abuzive.

Realizimi i strukturave të reja tregtare dhe prodhuese

Kjo strategji përfshin pjesën më të madhe të projekteve dhe të masave vepruese të Planit Përgjithshëm Kombëtar dhe të PINS Durana. Sygjeron ristrukturimin dhe zgjerimin e tregjeve komunale në Durrës si dhe zhvillimin të një zone të re ekonomike në pjesën e bonifikuar në Spitallë. Për sa i përket projektit të fundit, fushëveprimi dhe përcaktimi janë ato të përmbajtura në direktivat kombëtare të planifikimit.

Hartimi i strumentave të planifikimit

Kjo strategji njihet nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të GLP nëpërmjet planeve të detajuar (Plane Zbatimi), me objektivin për zhvillimin e zgjidhjeve specifike për zonat e territorit të bashkisë, të cilat kanë nevojë për studim dhe përpunim të mëtejshëm. Masat vepruese të kësaj strategjie i përkasin identifikimit të pjesëve specifike të territorit, të cilat për shkak të kushteve aktuale, kanë nevojë për një plan të detajuar. Ndër këto projekte, është identifikuar edhe një projekt për ripërcaktimin e zhvillimit të rivierës të zonës veriore në afërsi të Gjirit të Lalzit, e konsideruar si një zonë me potencial të madh ekonomik dhe mjedisor. Në vend të zhvillimit të strukturave turistike rezidenciale në brendësi të pishave përgjatë bregut, projekti sygjeron zhvillimin të një stabilimenti alternativ pas pyllit. Projekti, i menduar si një partneritet publik-privat, duhet të inkorporojë dhe në vijim të zhvillojë principet e përcaktuara nga GLP.

Veprimet strategjike për sistemin infrastrukturor

2.3.2

Realizimi i një sistemi kanalizimesh funksional për të gjithë territorin komunal

Strategjia bazohet në dy masa kryesore: nga njëra anë përfundimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza të Durrësit në zonat urbane që akoma nuk e shfrytëzojnë këtë shërbim; nga ana tjetër individualizimi i zgjidhjeve të mundshme për ato zona rurale jo të arritshme nga rrjeti kryesor i kanalizimeve të ujërave të zeza, dhe të cilat janë të lidhura me rrjete të vogla dhe impiante trajtimi lokale. Përveç kësaj, plani parashikon zhvillimin e mëtejshëm të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza të Durrësit.

Realizimi i një sistemi për riciklimin/shkatërrimin e mbetjeve të ngurta për të gjithë territorin e bashkisë

Strategjia prek një nga prioritetet kryesore për të gjithë territorin komunal, domethënë zbatimin e një sistemi funksional për shkatërrimin/riciklimin e mbetjeve urbane për të gjithë territorin e bashkisë. Strategjia bazohet në tre masa vepruese kryesore:

- e para i përket rritjes së kapacitetit dhe bonifikimit i shkarkimeve ekzistuese të Durrësit, në mënyrë që të përmbushë kërkesat për të gjithë rajonin;
- e dyta i përket mbylljes dhe bonifikimit e të gjitha shkarkimeve rurale prezente në territorin e bashkisë;
- e treta i përket zbatimit të një sistemi për grumbullimin dhe ripërpunimin e mbetjeve të ngurta në të gjithë territorin e Durrësit, që do të mblidhen në venddepozitimet në afërsi të Porto Romanos. Ky venddepozitim është ekzistues por duhet bonifikuar dhe të higjenizohet konform standarteve europiane, përveç se të zgjerohet për të arritur kapacitet e nevojshme për të grumbulluar sasinë e mbetje-

ve në të ardhmen.

Këto masa janë të mirë strukturuar në një seri projektesh specifike që synojnë përmirësimin me efikasitet të ciklit të plotë të menaxhimit të mbetjeve për Durrësin, i cili konsiston në promovimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të lëngshme nëpërmjet një sistemi të gjerë pikash grumbullimi, në mënyrë që të bëhet më eficientë transporti i mbetjeve dhe realizimi i vend kompostimeve lokale.

Realizimi i një sistemi hekurudhor për pasagjerë dhe transport mallrash

Një nga objektivat prioritare të planit është parashikimi i zhvillimit dhe rritja e kapacitetit të sistemit të transportit publik, nëpërmjet rikuperimit të sistemit ekzistues linjave hekurudhore për transportin e mallrave dhe pasagjerëve. Strategjia aderon dhe zbaton linjat udhëzuese të Planit Përgjithshëm Kombëtar si dhe PIN Durana.

Parashikohet dyfishimi i linjës (konsiderohet e nevojshme për një transport eficientë), rikuperimi i stacioneve ekzistuese hekurudhore që do të shndërrohen në qendra multi-modale për shkëmbimin e trenave, autobuzave dhe motorrave, ndërtimi i një stacioni të ri (ndërlidhës “hub modali” multi-lokal) në veçanti përgjatë linjave të Durrës-Tiranë dhe Durrës-Kavajë, në shërbim të komunitetit lokal që janë zhvilluar në ato zona. Nga ana tjetër linja hekurudhore do të shtrihet deri në zonën prodhuese që do të vendoset në Porto Romano.

Përmirësimi i transportit në rrugë

Pavarësisht se plani evidenton rëndësinë e transportit publik dhe të qarkullimit të ngadaltë, ajo përmban edhe një strategji që synon të përmirësojë kushtet rrugore. Kjo strategji tenton jo vetëm të përmirësojë efikasitetin dhe sigurinë e transportit në rrugë nëpërmjet përmirësimit të përgjithshëm të infrastrukturës rrugore në zona delikate (me semaforë, trotuare, vijat e bardha për kalim këmbësorësh), por e njeh rrugën edhe si një hapësirë të rëndësishme publike në territorin komunal – sidomos në ato pika ku lidhjet rrugore kanë qenë tepër të rëndësishme për zhvillimin urban (si zona e Sukthit dhe Katundit të Ri). Masat vepruese specifike në brendësi të kësaj strategjie i përkasin:

- përfundimin e rrugës për në Porto Romano;
- ndërtimi i një rruge tangjenciale në Durrës për përmirësimin e kushteve të trafikut në qendër të dytëtit dhe lehtësimin e aksesit nëpër kodrat e Durrësit;
- konvertimi i hyrjes së autostradës për në qytetin e Durrësit në një bulevard urban;
- rikualifikimi i aksit rrugor veri-jug, si një rrugë e përdorur aktualisht për në Porto-Romano dhe aksi rrugor alternativ veri-jug që përshkon Suktin dhe Katundin e Ri.

Realizimi i një rrjeti të qarkullimit të ngadaltë

Kjo strategji i përket zhvillimit të një rrjeti për qarkullimin e ngadaltë si të çiklistëve ashtu edhe të këmbësorëve. Pavarësisht se numri i automjeteve po shtohet në mënyrë të shpejtë në Durrës, ekziston një pjesë e madhe e popullsisë që qarkullon me mjete publike, biçikleta dhe në këmbë. Strategjia parashikon masat vepruese si më poshtë:

- zhvillimin e korsive për biçikleta përgjatë hekurudhës Durrës-Tiranë dhe në të gjitha rrugët që shtrihen në veri-jug dhe janë objekt për rikualifikimin me vëmendje të veçantë për një korsie të re për biçikletat / këmbësorët midis Porto Romanos dhe Golemit;
- zhvillimi i një korsie për biçikleta përgjatë lumit Erzen dhe mbi të gjitha në zonën e Sukthit dhe Katundit të Ri;
- zhvillimi i një mbikalimi pedonal dhe për biçikleta për ato infrastruktura rrugore që ka qarkullim të lartë.

Rehabilitimi i Portit të Durrësit

Nëpërmjet zhvendosjes së aktivitetëve industriale në Porto Romano, hapet mundësia e konvertimit të portit të Durrësit për përdorim vetëm për qëllime turistike nëpërmjet realizimit të një marine të re, duke sjell rehanilitimin e zonës portuale dhe një nxitje të turizmit.

Veprimet strategjike për sistemin ujor

2.3.3

Përmirësimi i aseteve hidrogeologjike

Shtirja e gjerë e kodrave dhe fushave aluvionale, në të cilat drenimi paraqet një problem, e përbën parësore përmirësimin e aseteve hidrogeologjike për territorin e Durrësit. Katër masa vepruese kyçe janë parashikuar në brendësi të kësaj strategjie:

1. mbledhja e ujërave të shiut dhe e sedimenteve në pjesën e sipërme të skarpave, në mënyrë që të ulet shpëlarja e lumenjve dhe zvogëlohet fenomeni gërryes i Lumit Erzen, gjithashtu edhe përmirësimi i rrjetit të drenimit;
2. heqja e sedimenteve të depozituar në fund të shtratit të lumit Erzen (strategji për një periudhë më afatgjatë);
3. monitorimi i përhapjes së përmytjeve nëpërmjet ruajtjes dhe shtimit të argjinaturave ekzistuese në zonën Sukth i Ri / Kantud i Ri;
4. zhvillimi i masave parandaluese në zonat që përmyten (zona Sukth / Katund i Ri (psh. Jube) dhe në afërsi të grykëderdhjes së lumit Erzen).

Mbrojtja e rivierës

Linja e detit në veri të Durrësit, e gjendur në kufi me zonën fushore aluvionale të lumit Erzen, paraqet një linjë kufiri midis tokës dhe ujit. Lëviz nën ndikimin e veprimit të kombinuar të fluksit të lumit dhe sedimenteve të tij, detit dhe erës. Strategjia synon të garantojë sa më shumë aktivitetet ekzistuese - dhe ato të parashikuara nga planifikimi përgjatë rivierës, duke e ruajtur karakteristikat e bregdetit.

Veprimet strategjike për sistemin natyror

2.3.4

Monitorimi i rreziqeve ndaj bregdetit dhe zhvillimi i ndërhyrjeve për parandalimin e rrëshqitjeve të tokës

Një ndër masat vepruese kryesore kundër rreziqeve mjedisore të Bashkisë së Durrësit, si rrjedhojë e pozicionimit gjeografik të këtij territori, është ruajtja e vijës bregdetare. Kjo strategji konsiston kryesisht në dy projekte kyçe: monitorimi i ndotjes së detit në mënyrë që të kontrollohet cilësia e ujit dhe parandalimi i erozionit bregdetar, duke marrë parasysh përbërja delikate gjeologjike e terrenit.

Masa tjetër vepruese kryesore konsiston në parandalimin e shëmbjeve të dherave dhe fenomenit të erozionit dhe gërryerjes së kodrave. Kjo masë parashikon kryesisht dy projekte kyçe: përforsimi i zonës delikate të pjerrët në veri të qëndrës së Durrësit nëpërmjet rimodelimit të terrenit dhe zhvillimi i pyllëzimit në zonat e rrezikut.

Zhvillimi i një politike për ruajtjen e territorit

Janë konsideruar masa të ndryshme vepruese si rrjedhojë e pasurive të shumta natyrore në brendësi të bashkisë së Durrësit:

- përcaktimi i politikave për ruajtjen e Kapit të Rodent, në veçanti duke u përqëndruar në mbrojtjen e florës dhe biodiversitetit;
- mbrojtja e pyjeve si Bishti i Pallës, Kepi i Rodonit, Gjiri i Lalzit, Gërdeci, Manëz dhe ruajtja e pishave në Plazhin e Shën Pjetrit në LuminTarinit (Gjiri i Lalzit);
- ruajtja dhe mbrojtja e grykëderdhjeve të Lumit Erzen dhe Ishëm, të karakterizuara nga vlera të larta ekologjike;
- ruajtja dhe mbrojtja e parkut urban të maleve të Durrësit për vlerën e tyre si një mundësi argëtimi dhe bujqësor.
- ruajtja e resurseve ujore si ajo e Tarinit dhe e Topanasit në mënyrë që të ruhet cilësia e ujit dhe të ruhet niveli i prurjeve;
- ruajtja e zonave përreth fshatrave kodrinor nga Lalëz dhe Shetaj me qëllimin e ruajtjes së peisazhit natyror dhe mjedisin e vendit.

Realizimi i infrastrukturës për përdorim publik

Plani identifikon tre masa vepruese kryesore të destinuar ti kthejnë zonave natyrore prestigjin që meritojnë, dhe të bëhen të aksesueshme nga gjithkush duke i kthyer edhe në një destinacion rikreativ. Këto masa vepruese shkojnë krah për krah me zhvillimin e vizionit strategjik të territorit të Durrësit, Shijakut dhe Vorës, që synon në ndërtimin e një parku rajonal.

Masa e parë vepruese për Bashkinë e Durrësit konsiston në pajisjen e parkut me shërbimet e ndriçimit, për shembull nëpërmjet realizimit të hapësirave për aktivitete kreative, pika panoramike dhe zona pushimi.

Masa e dytë vepruese konsiston në vlerësimin e baseneve hidrike kryesisht duke ruajtur karakteristikat e tyre natyrore dhe duke përmirësuar funksionin e tyre argëtues.

Masa e tretë vepruese synon të përmirësojë aksesibilitetin në park, duke përcaktuar një rrugë kryesore jo vetëm shtegun dytësor malor (shiko hartën), në mënyrë që të ruhet rrjeti i qarkullimit të ngadaltë dhe ndërtimi i lidhjeve që mungojnë përgjatë Lumit Erzen.

Masat vepruese strategjike për sistemin bujqësor

2.3.5

Ruajtja dhe forcimi i sistemit bujqësor

Në mënyrë që të ruhet dhe forcohet sistemi bujqësor në Bashkinë e Durrësit, plani parashikon dy masa vepruese kryesore:

- Promovimi i ripërdorimit të taracave kodrinore nëpërmjet kultivimit të kulturave të cilësisë së lartë si ullishte, vreshta dhe pemishte në terrene më sipërfaqe 10-20 ha me avantazhin e dyfishtë të rivendosjes së një zhvillimi ekonomik shumë produktiv si dhe ruajtjen e territorit kodrinor të vendit;
- Ruajtja dhe promovimi i agrikulturës mikse e karakterit familjar në ara me pjerësi si dhe në fusha, me qëllimin e kultivimit në sipërfaqe më të vogla që variojnë nga 0,4-3 ha, që përfaqësojnë tipologjinë e terrenit më të përhapur në agrikulturën familjare.

Mbështetja e prodhimit bujqësor

Në mënyrë që të mbështetet me efikasitet prodhimi bujqësor në Bashkinë e Durrësit, plani identifikon tre masa vepruese kryesore:

- Mbështetja dhe promovimi i objekteve në shërbim të bujqësisë;
- Përmirësimi i sistemit të vaditjes dhe drenimit, në veçanti në sektorët e kultivimit cilësor;
- Promovimi i ekonomisë lokale nëpërmjet ndërtimit të tregjeve në të cilët do të bëhet e mundur shitja në mënyrë më eficiente e prodhimit vendas.

Promovimi i konsumimit të energjive alternative (të qëndrueshme)

Në mënyrë që të paraqiten metoda alternative dhe më të qëndrueshme të prodhimit të energjisë, edhe në sektorin bujqësor, është vërejtur shtrirja e madhe e terreneve të papërshtatshëm për kultivim, masat vepruese të planit të identifikuar i përkasin:

- Prodhimit të biomasës (cikle të shpeshta ripërtëritje nga biomasa) në një shkallë të gjerë në zona me shtrirje të madhe të papërshtatshme për përdorim bujqësor (për përdorim privat -publik);
- Prodhimi i biomasës në shkallë të vogël për përdorim privat.

Verifikimi i koherencës

2.4

Qëllimi i këtij hapi është për të parë nëse ka mospërputhje që mund të pengojnë zhvillimin dhe zbatimin e mëvonshëm të planit të paraqitur për VSM.

Në veçanti, analiza e koherencës së jashtme kontrollon pajtueshmërinë e veprimeve strategjike të planit në lidhje me objektivat që rrjedhin nga plane dhe programe të niveleve më të larta hierarkike dhe të zonave të ndryshme territoriale (më të gjerë se plani në shqyrtim) të hartuar nga nivele më të larta të qeverisë.

Pas ndryshimeve të legjislacionit kombëtar në fushën e planifikimit, procesi i planifikimit, aktualisht, është i organizuar sipas një strukture hierarkike, në krye të së cilës është edhe *Plani i Përgjithshëm Kombëtar*. Ndjekin planin rajonal dhe planet sektoriale. Planet e përgjithshme lokale për Bashkitë Durrës, Shijak dhe Vorë, kanë marrë si referencë direktivat kombëtare, standardet dhe rregulloret e përmbajtura në Planin e Përgjithshëm Kombëtar, në Planin e Integruar Bregdetar Ndërsektorial dhe në Planin Ndërsektorial të Zonës Ekonomike të Tiranë-Durrësit. Këto plane, të hartuara nga AKPT dhe aktualisht në fazë miratimi, lidhen drejtpërdrejt dhe në pjesën më të madhe nga territoret e tri komunave nën analizë.

Në vijim të linjave udhëzuese të planit, janë konsideruar brezat tampon të zonës natyrore dhe kulturore ashtu si edhe brezat e sigurisë që rrjedhin nga ligji shqiptar.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar

2.4.1

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) ofron udhëzime dhe drejtim strategjik në terma të zhvillimit territorial për të gjithë vendin. PPK siguron një kuadër të përgjithshëm për zbatimin e planifikimit për të gjitha njësitë vendore. Plani është i ndarë sipas pesë sistemesh territorial - urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor. Për secilin prej këtyre sistemeve plani identifikon drejtimet dhe udhëzimet e përgjithshme.

Sa i përket *sistemit urban*, plani rekomandon një zhvillim policentrik të qendrave ekzistuese urbane dhe dendësimi e tyre, përcaktimin e një dimensionit rajonal nëpër disa qytete dhe promovimin e një menaxhimi të ndjeshëm të burimeve urbane.

Sa i përket *sistemit natyror*, plani rekomandon mbrojtjen dhe shtimin e burimeve natyrore të vendit nëpërmjet shtimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe krijimit e konsolidimit të korridoreve të lidhjeve natyrore.

Sa i përket *sistemit bujqësor*, plani njihet rolin potencial të bujqësisë shqiptare dhe prandaj rekomandon ruajtjen e zgjerimit maksimal të tokave bujqësore (ndërtimi nuk do të lejohet në fushat bujqësore), krijimin e një zinxhiri ekonomik që shkon nga prodhimi në eksport, integrimi dhe bashkëpunimi me sektorë të tjerë të ekonomisë dhe krijimin e qendrave dhe poleve që përmbushin kërkesat e prodhimit bujqësor.

Sa i përket *sistemit ujor*, plani rekomandon mbrojtjen e burimeve ujore dhe krijimin e rrjeteve për grumbullimin e ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm.

Në lidhje me *sistemin infrastrukturor*, plani synon të arrijë një integrim të përgjithshëm hapësinor në mënyrë që ta bëjë gjithë territorin të arritshëm dhe të organizuar në mënyrë hierarkike, të zhvillojë një rrjet të shpërndarjes së energjisë efikase dhe për të përmirësuar energjitë e ripërtëritshme.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar prek bashkitë e Durrësit, Shijakut dhe Vorës si më poshtë:

Profili ekonomik i rajonit është i programuar për të nxjerrë fusha të tilla si shërbime, tregti, turizëm, bujqësi, dhe për të qenë platforma kryesore kombëtare për transportet dhe energjitë për import dhe shpërndarje.

1. Turizmi në rajon duhet të bazohet dhe mbështetet nga të mirat mjedisore dhe kulturore të zonës;
2. Lëvizshmëria e ardhshme duhet të synojë forcimin e aksesit dhe zhvendosjen në të gjithë rajonin, duke lehtësuar ndërlidhjen midis komuniteteve të ndryshme, të mëdha dhe të vogla. Në Durrës, projektet strategjike kombëtare që lidhen me projektimin dhe zhvillimin e korridorit blu (një rrugë turistike bregdetare që shtrihet nga veriu në jug të Shqipërisë); zbatimi i Korridorit VIII si transporti rrugor kryesor për mallrat; rimëkëmbja e rrugës Egnatia, një rrugë e rëndësishme turistike historike; zbatimi i korridorit Durrës - Kukës - Prishtinë - Nis për t'u lidhur pastaj me Korridorin X; zhvillimi i portit të Durrësit, si porti kryesor shqiptar; zhvillimi dhe përcaktimi i portit industrial të Porto Romanos; ristrukturimi i gjithë sistemit hekurudhor që e ka qendrën kryesore në Durrës.
3. Energjia: Porto Romano pritet të bëhet një nga dy portet kryesore të energjisë së vendit.
4. Përmirësimi i peizazhit urban të Durrësit nëpërmjet restaurimit, konsolidimit të strukturës urbane dhe mbrojtjes së trashëgimisë së saj.
5. Zhvillimi i mjedisit natyror duke ruajtur burimet natyrore përmes integritetit të parqeve ekzistuese nacionale dhe duke siguruar një cilësi të mirë të jetës dhe të biznesit. Plani bën thirrje për një zhvillim urgjent të menaxhimit të mbeturinave

në cikël të mbyllur.

Plani i Integruar Ndersektorial Bregdeti

2.4.2

Plani i integruar bregdetar përcakton drejtimet kryesore të zhvillimit hapësinor për bregdetin shqiptar, kufirin jugor me Greqinë, dhe në veri me Malin e Zi. Plani siguron integrimin e politikave territoriale në kontekstin e zhvillimit ekonomik. Plani synon një përdorim dhe menaxhim të qëndrueshëm të zonave bregdetare, duke ruajtur mjedisin e tyre natyror, peizazhet e tyre, burimet e tyre natyrore dhe ekosistemet lokale dhe promovimin e formave të qëndrueshme të turizmit. Ai përmban disa udhëzime të përgjithshme që mbulojnë shumë aspekte, por që gjithsesi ofrojnë udhëzime apo sugjerime për planifikimin e bashkive të zonave bregdetare shqiptare.

Për zonat e bashkisë së Durrësit plani tregon strategjitë për menaxhim më të mirë të burimeve lokale dhe zhvillimin cilësor të turizmit. Brenda nëndarjes në zona më gjithë bregdetin, zona e Durrësit ndodhet në një pikë vendimtare që i përket rajonit ekonomik Tiranë-Durrës, për të cilën ka një tjetër ndër-sektorial, dhe që është tejet e urbanizuar, ndryshe nga shumica e bregdetit.

Duke iu referuar tabelave që shoqërojnë raportin e projektit, plani duket se ndikon në bashkinë e Durrësit si më poshtë:

- duke sugjeruar zgjerimin urban dhe reduktimin e shtrirjes urbane nëpërmjet konsolidimit të pëlurës urbane ekzistuese - kjo do të jetë e dobishme për aktivitete bujqësore në rajon, siç thuhet në Planin Kombëtar;
- duke propozuar ndërtimin e një rruge bregdetare, paralel me bregdetin shqiptar nga veriu në jug;
- duke propozuar përforcimin e infrastrukturës dhe rrjetit hekurudhor;
- duke forcuar sektorin e peshkimit në shtrirjen bregdetare Durrës-Velipojë;
- duke reduktuar ndotjen e ujit përmes kontrollit të shkarkimit të ujërave të zeza në det;
- duke sugjeruar ndërtimin e porteve turistike.

Plani i Integruar Ndërsektorial Durana

2.4.3

Plani sektorial për rajonin Tiranë-Durrës (Durana) synon të krijojë kushte optimale për aktivitetin ekonomik në zonën mes qyteteve të Tiranës dhe Durrësit; të përmirësojë cilësinë e jetës së banorëve të një nga rajoneve më të populluara të vendit; të mbrojë

burimet natyrore ekzistuese, pavarësisht nga abuzimet e viteve të fundit; të përmirësojë infrastrukturën dhe nivelin e përgjithshëm të aksesit në zonë. Bashkitë e Durrësit, Shijakut dhe Vorës janë ndikuar fuqimisht nga kërkesat dhe udhëzimet e përfshira në planin si më poshtë:

- Toka është përshkruar përgjithësisht si një strukturë policentrike urbane, me hierarki të qartë nga një qendër metropolitane (Tirana), qendra kryesore (të tilla si Durrësi), qendra të mesme (si Shijaku, Vora) dhe qendrat lokale (si Sukthi). Prirjet e ndryshme dhe plotësuese të këtyre qendrave janë: turizmi, veprimtaritë portuale, logjistika, prirja industriale dhe socio-kulturore për qytetin e Durrësit; logjistika dhe strehimi alternativë ekonomik për Vorën; bujqësia dhe strehimi ekonomik për Sukthin dhe Shijakun.
- Sa i përket zhvillimit ekonomik të zonës, plani sugjeron përmirësimin e veprimtarive portuale në Durrës dhe Porto Romano; zhvillimin e një qendre logjistike dhe një parku energjetik Spitallë; përqendrimi i shërbimeve dhe aktiviteteve prodhuese në segmentin Durrës - Porto Romanos dhe përgjatë SH2 jashtë Durrësit; forcimin e aktiviteteve bujqësore në zonat rurale; zhvillimin e një rrethi të tekstilit në Xhafzotaj dhe logjistike shpërndarës në Rrashbull dhe Vore; zhvillimin e një qendre të re ekspozitash (Expo) në Prezë së bashku me tregjet e disa fermerëve, për shembull në Vorë dhe Sukth.
- Sa i përket infrastrukturës, plani sugjeron përmirësimin e nivelit të aksesit në nivel rajonal. Përveç forcimit të aktiviteteve portuale në portin e Durrësit dhe Porto Romano, plani tregon mundësinë e dy porteve të reja turistike që do të ndërtohen përgjatë bregdetit, një në zonën urbane të Durrësit dhe një në sektorin verior bregdetar; përmirësimin dhe rikualifikimin e linjës hekurudhore me një rrugë të re në aeroportin e Tiranës; shpërndarjen e qendrave të ndryshme multimodale (me ato kryesore në Durrës dhe Vorë dhe të tjera të mesme), një aks të ri të autostradës që shtrihet drejt jugut të rrugës ekzistuese E762e kalon nëpër rajonin e Bërxullës.
- Sa i përket turizmit, rajoni siguron përfitimet duke qenë një nga pjesët më të arritshme të vendit. Aktivitetet turistike do të jenë të lidhura me promovimin e shërbimeve turistike (mjekësore, palestër, konferenca, etj); promovimin e turizmit qytetas në Ishëm dhe Lalz; krijimin e turneve kulturore dhe agro-turizmit, duke përfshirë shëtitje në këmbë dhe *mountain bike*; duke krijuar një sektor kulturor të bazuar në një strategji që nxit potencialin territorial të zonës, si deti, kodrat, vendet arkeologjike, etj.
- Sa i përket sektorit bujqësor, plani tregon rëndësinë e zhvillimit të hapësirave të përshtatshme për mbledhjen, shpërndarjen, përpunimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore. Ky koncept ka për qëllim prodhimin e një zinxhiri ushqimor nga prodhimi tek shpërndarja. Planit gjithashtu sugjeron forcimin e prodhimit bujqësor

si më poshtë:

• Sa i përket mjedisit, zona karakterizohet nga lugina e lumit Erzen, i cili derdhet në gjirin e Lalzit. Niveli i ndotjes dhe gjendja e përgjithshme mjedisore e lumenjve kërkon veprim të menjëhershëm. Planit thekson rëndësinë e një furnizimi të mirë rajonal me ujë, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe ndërtimin e një strategjie për menaxhimin e përmytjeve. Në një shkallë rajonale, plani gjithashtu tregon idenë e ruajtjes së peizazhit kodrinor aktual dhe përforcimin e tij nëpërmjet zgjerimit të brezit të gjelbër të Tiranës deri në Kepin e Rodonit, në territorin e bashkisë së Durrësit.

Planet strategjike

2.4.4

Bashkitë e Durrësit dhe Shijakut kanë zhvilluar kohët e fundit një plan strategjik 2015-2030. Në nivelin e njërive të qeverisjes vendore, strategjia territoriale është mjeti më i lartë i planifikimit territorial. Ajo përmban vizionin, prioritetet, objektivat, metodat dhe rezultatet e pritshme të zhvillimit social dhe ekonomik të bashkisë të mbi 15 viteve të ardhshme. Këto plane duhet të vendosen në bazë të prioriteteve të përcaktuara në Planin të Përgjithshëm Kombëtar, në planet ndër-sektoriale për bregdetin e Shqipërisë dhe të rajonit Tiranë-Durrës dhe direktivave të tjera kombëtare. Me këto plane strategjike, qëllimi i bashkive është të zhvillojë një vizion për zhvillimin e qyteteve të tyre për 2030 dhe të udhëheqë ndërtimin e zhvillimit ekonomik dhe social të bazuar në potencialin e zonës dhe burimet ekonomike, mjedisore dhe sociale. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre planeve për zhvillimin e planit të përgjithshëm vendor, tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të shkurtër të objektivave të identifikuar.

Strategjia Territoriale Bashkia Durrës 2015-2030

Për sa i përket pesë sistemeve territoriale, këshillat e planit janë si më poshtë:

- Sistemi Urban: Në njëzet vitet e fundit, sistemi urban i bashkisë së Durrësit ka pësuar transformim të thellë që ka çuar në ndryshime të thella në dendësinë e qytetit, në hapësirën dhe në kontekstin social. Zona bregdetare është e kërcënuar nga rrëshqitjet e tokës dhe nuk është e pajisur në mënyrë të mjaftueshme me infrastrukturë. Për më tepër, trashëgimia historike e qytetit është dëmtuar seriozisht nga aktivitetet e ndërtimit. Planit parashikon integrimin e Lalzit në një strategji rajonale të turizmit dhe identifikon potencialin për Kullën si një qendër për flukset e transportit lokal.
- Sistemi Natyror: korridoret natyrore janë ndikuar shumë nga prania e gjerë e

zonave urbane. Plani sugjeron mbrojtjen e zonës së Kallmit, promovimin e formave me ndikim të ulët të turizmit dhe rizbulimin e *brendatokës* si një destinacion të mundshëm turistik.

- Sistemi Bujqësor: Pavarësisht këtij potenciali, bujqësia dhe peshkimi përbëjnë vetëm 1.3% të aktiviteteve ekonomike në Durrës. Në lidhje me sistemin natyror, plani sugjeron rivendosjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit, i cili ka qenë i dëmtuar rëndë, dhe zhvillimin e tregjeve të reja lokale.
- Sistemi Ujor: Megjithë bollëkun e ujit në Durrës - deti shërben si një korridor për lidhje ndërkombëtare - shumë çështje të rëndësishme që lidhen me praninë e këtyre burimeve duhet të merren parasysh: përmirësimi i luginës së Erzenit, prania e akuifereve të rëndësishme që furnizojnë qytetin me një linjë të re të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve.
- Sistemi Infrastrukturor: Kushtet rrugore të Durrësit janë të mira. Deponitë e Porto Romanos, për arsye mjedisore, duhet të ishin mbyllur në vitin 2015.

Plani gjithashtu propozon një numër të objektivave strategjike:

- Bërja e qytetit një platformë për këmbim dhe qendër logjistike për rajonin e Ballkanit dhe të Evropës Juglindore;
- Bërja e Durrësit tërheqës për investitorët e huaj dhe vendas dhe një motor për ekonominë shqiptare;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve të Durrësit (me sektorët kyç të tilla si sektori administrativ, zhvillimi i bujqësisë dhe shpërndarja e produkteve, turizmit, transportit publik dhe lëvizshmërisë së ngadalshme, infrastrukturës).

Strategjia Territoriale Bashkia Shijak 2015-2030

Për sa i përket pesë sistemeve territoriale, këshillat e planit janë si më poshtë:

- Sistemi Urban: Plani thekson pozitën gjeografike strategjike të Shijakut;
- Sistemi Natyror: Lumenjtë janë duke u bërë gjithnjë e më shumë një kërcënim për të cilat duhet të merret veprim;
- Sistemi Bujqësor: Uji i pranishëm në Xhafzotaj mund të përdoret për ujitje; infrastruktura e ujitjes duhet të përmirësohet.
- Sistemi Ujor: Cilësia e ujit të lumit Erzen është e dobët. Ka peshk në pellg. Cilësi e mirë e ujërave nëntokësore.
- Sistemi Infrastrukturor: Ka lidhje të paligjshme në furnizimin me ujë; kanalizimet

nuk janë përfunduar, deponimi i mbeturinave është vetëm 1 km larg qytetit; mbetjet hidhen në lumin Erzen; ka disa deponi ilegale.

Plani gjithashtu propozon një numër objektivash strategjike:

- Ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit natyror të komunës;
- Planifikimin, ndërtimin dhe rivendosjen e zonave të arritshme, me shërbime dhe objekte efikase;
- Vazhdimin e punës për të forcuar rolin e qytetit si një qendër e tregtisë dhe punësimit në zonën qendrore të Shqipërisë, në përputhje me politikatat kombëtare të zhvillimit ekonomik;
- Përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët me anë të ndërtimit të ndërtesave, rrugëve dhe hapësirave publike në tërë territorin me karakteristika të mira;
- Zhvillimi i një rrjeti të transportit efikas dhe efektiv dhe investime në përmirësimin për furnizimin me ujë të pijshëm dhe infrastrukturën e ujërave të zeza.
- Nxitja e një modeli të rritjes dhe përdorimit të tokës që nxit një zhvillim ligjor, efikas dhe të padëmshëm për mjedisin;
- Sigurimi që rritja në bashki gjatë periudhës së zbatimit të planit, qoftë e arrirë përmes aplikimit të praktikave efikase, metodave ekonomike dhe nga një pikëpamje mjedisore të arsyeshme dhe nëpërmjet përpjekjeve dhe angazhimit të banorëve, partnerëve lokalë dhe bashkëpunimit ndërmjet dhe autoritetet rajonale.

3 Aspektet metodologjike

3.1 Leximi i territorit nëpërmjet treguesve

Njohuritë e studimit në komponentë të ndryshëm të mjedisit është bërë nëpërmjet treguesve. OECD, *Organisation for Economic Cooperation and Development* (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) (1993), me termin tregues identifikon “një instrument që mund të ofrojë informacion në formë të përmbledhur të një fenomeni më kompleks dhe në një kuptimin më të gjerë; një instrument në gjendje të bëjë një prirje të dukshme apo një fenomen që nuk është menjëherë i dukshëm. “

European Environment Agency (Agjencia Evropiane e Mjedisit) (EEA, 2005) e përkufizon një tregues si “një masë, në përgjithësi sasiore që mund të përdoret për të ilustruar dhe komunikuar fenomene komplekse më thjesht, duke përfshirë tendencat dhe përparimin me kalimin e kohës”. Një tregues ofron një pasqyrë të një fenomeni të madh apo vështirësisht të regjistrueshëm, me fjalë të tjera është një aspekt i matshëm i një projekti apo një mjedisi të dhënë apo të një kompanie, e cila mund të përdoret për të karakterizuar shtetin apo për të monitoruar ndryshimet.

Në një VSM, treguesit duhet të përdoren për të “matur dhe thjeshtuar informacionin në mënyrë që të lehtësojnë, si nga ana e vendimmarrësit ashtu edhe nga publiku, të kuptuarit e bashkëveprimit midis mjedisit dhe çështjeve kryesore të sektorit dhe të shpjegojë ndryshimet në kohë” një nga karakteristikat kryesore të treguesit, në fakt, është zvogëlimi i vëllimit dhe kompleksitetit të informacionit të kërkuar nga vendimmarrësit (Donnelly et al., 2007).

Në nivel ndërkombëtar, edhe pse është një listë e treguesve e përcaktuar nga BE-ja “*Towards Environmental Pressure Indicators for the UE*” – “*TEPI*” publikuar nga Eurostat), tani është kuptuar nevoja për t’u lënë komuniteteve të veçanta autonominë për të zgjedhur treguesit më të përshtatshëm për situatën lokale në mënyrë që të përfaqësojnë më mirë mjedisin e tyre të veçantë.

Në rastin e planifikimit ndër-bashkiak të pasurisë së territorit, duke pasur parasysh nivelin e natyrës strategjike të veprimeve që duhen konsideruar në vlerësime dhe, prandaj, vështirësia e përcaktimit të ndikimeve specifike dhe matje objektive, sigurisht treguesit duhet të kenë karakteristikën e të qenit të negociueshëm edhe përmes qasjeve përshkruese dhe cilësisë.

Për më tepër, prania e niveleve të planeve/adresave të nivelit të lartë, të ndërtuara në bazë të parimeve të qëndrueshmërisë, duhet të bëjnë të mundur vlerësime bazuar në nivelin e arritjes së objektivave të përcaktuara nga këto instrumente (ose të paktën në nivelin e koherencës/afërsisë).

Duke marrë parasysh këto konsiderata, pavarësisht mundësisë për të përsosur zgjedhjet, besohet të jetë në gjendje për të analizuar mundësitë e planit të parashikuara në Planin Territorial Lokal të Durrësit, Shjiakut dhe Vorës, duke kontrolluar e “*performances*” e skenarëve në lidhje me treguesit e deduktueshëm si nga sistemi i objektivave të planifikimit të nivelit të lartë, ashtu edhe nga praktikatat më të mira të zbatuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Prandaj, për identifikimin e treguesve, duke marrë parasysh nivelin e përcaktimit të planit dhe llojin e informatave në dispozicion, besohet se mund t'i referohemi te klasifikimi në vijim:

- treguesit e planit:
o treguesit/synimet e qëndrueshmërisë;
- treguesit territorial:
o mjedisor;
o ekonomik;
o social.

3.1.1 Treguesit e planit për verifikimin e koherencës

Sa për grupin e parë të treguesve (treguesve të Planit), në thelb bëhet fjalë për tregues të performancës që duhet të *masin* koherencën me objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore. Për këtë të fundit do t'u referohen në mënyrë të veçantë të treguesve/objektivave të përcaktuara në Manualin e DG XI të Komunitetit Evropian, të zhvilluara për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planeve të Zhvillimit Rajonal dhe Programeve të Fondeve Strukturore të Bashkimit Evropian.

Përputhshmëria më e madhe ose më e vogël e planit me këto kritere (ose të paktën me ato të zgjedhura si në harmoni me shkallën dhe llojin e veprimeve për t'u vlerësuar) është padyshim një përfaqësim i mirë i qëndrueshmërisë më të madhe apo më të vogël të tij.

3.1.2 Modeli PPGNP për treguesit territorial

Vlerësimi Strategjik Mjedisor ndihmon për të identifikuar, së bashku me projektuesin e planit, zgjidhjen optimale për të përmbushur nevojat urbane dhe kërkesat mjedisore, duke vlerësuar pasojat në mjedis, duke shmangur ndikime të rëndësishme dhe duke i kufizuar me masat e duhura të zbutjes dhe/ose kompensimit. Kështu që ky nuk është një Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM), por më tepër një vlerësim gjatë ndërtimit, e përdorur në formë strategjike, me qëllim identifikimin e zgjidhjes më të mirë të mundshme dhe të qëndrueshme, mbi të cilën do të bazohen planet e detajuara në vijim dhe projektet.

Për të përcaktuar më mirë dhe thjesht sistemin kompleks territorial, vazhdohet me anë të metodave të llogaritjes të bazuara në tregues. Përvojat e shumta, me kalimin e kohës, kanë lejuar identifikimin e treguesve kryesorë që lejonë përshkrimin më së miri të mjedisit, megjithatë, nga koha në kohë zbatohen me tregues shtesë karakteristik të vendit. Në rastin në fjalë, do të përdoren tregues të njohur në nivel ndërkombëtar, sipas modelit

PPGNP: forca Përcaktuese të përkufizuara Presionet, që e ndryshojnë Gjendjen e mjedisit, duke gjeneruar Ndikime të cilat kërkojnë Përgjigje të dizajnuara për të:

1. rregulluar forcat;
2. reduktuar presionet;
3. përmirësuar gjendjen e mjedisit;
4. eliminuar, zbutur ose kompensuar ndikimet.

Për modelin PPGNP vlejné përkufizimet e mëposhtme:

- Përcaktorët (P): veprimet pasuese të nevojave natyrore, sociale dhe ekonomike. Ata janë stili i jetesës, proceset ekonomike, nga të cilët rrjedhin presionet në mjedis;
- Presionet (P): efektet e forcave përcaktuese, d.m.th. aktivitetet dhe sjelljet e njeriut në mjedis;
- Gjendja (G): cilësia dhe karakteristikat e mjedisit dhe burimeve, vlera që mund të ndryshohet nga presioni;
- Ndikimet (N): ndryshime të rëndësishme në gjendjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore, ndryshimet e ekosistemit, shëndetit të njeriut;
- Përgjigjet (P): masat e zbatuara për të përballuar ndikimet drejtuar një ose më shumë përbërësi të PPGNP.

3.1.3 Vështirësi të hasura gjatë përgatitjes së raportit mjedisor

Procesi i vlerësimit ka vënë në dukje, që nga analizat e para, disa vështirësi, të përfaqësuara kryesisht nga mungesa e të dhënave mjedisore të sakta dhe të përditësuara, kryesisht për shkak të nje rrjeti të zbulimit dhe monitorimit ende në proces strukturimi dhe për shkak të sistemeve të shpërndarjes të të dhënave ende të pazhvilluar plotësisht.

3.2 Vlerësimi i alternativave të planit

Vlerësimi i skenarëve të mundshëm është një çështje kyçe në vlerësimin mjedisor të planeve dhe programeve.

Me skenar nënkuptohet:

- “[...] një përshkrim i një grupi të mundshëm ngjarjesh, të cilat mund të ndodhin në mënyrë të arsyeshme. Qëllimi kryesor i zhvillimit të skenarëve është të stimulojë të menduarit në lidhje me ngjarje të mundshme (ndodhi), postulate (supozimet) në lidhje me këto ngjarje, mundësitë dhe rreziqet e mundshme dhe në lidhje me kryerjen e veprimit “(Karke et al 1998.);
- “[...] një vizion, në thelb, koherent me atë që mund të jetë e ardhmja - jo një parashikim, por një rezultat i mundshëm në të ardhmen” (Porter, 1985);
- “[...] një instrument për të renditur perceptime të caktuara për mjedisë të ardhshme alternative, në të cilët disa vendime mund të vihen në zbatim” (Schwartz, 1996);
- “[...] një grup përfundimesh të arsyeshme dhe bindëse në të ardhmen, por të ndryshëm në thelb” (Van der Heijden, 1996);
- “[...] hamendësime rreth asaj çfarë mund të ndodhë në të ardhmen” (Cornish, 2004).
- “Një përshkrim i mundshëm dhe shpesh herë i thjeshtuar për se si mund të zhvillohet e ardhmja, bazuar në një grup parashikimesh të besueshme rreth forcave lëvizëse dhe marrëdhënieve zinxhir. Skenarët mund të jenë rrjedhime nga parashikimet, por shpesh janë të bazuara në informata shtesë nga burime të tjera, ndonjëherë të kombinuara me një narrativë. “

Në planifikim dhe programim, koncepti i të ardhmes si pritshmëri e realizimit të një ideje apo një sërë veprimesh dhe masash apo edhe një veprë, është implicit. Në mënyrë të ngjashme, vlerësimi i efekteve mjedisore që këto instrumente përcaktojnë në një dimension hapësinor dhe kohor të mëvonshëm dhe si pasojë e zbatimit të tyre, bazohet në vlerësimin e të ardhmeve të mundshme të projektuara nga vetë instrumentet. Një nga angazhimet kryesore të vlerësimit mjedisor, për këtë arsye, është pikërisht eksplorimi i të ardhmeve alternative që mund të dalin si rezultat i zbatimit të një plani për të siguruar informacion të dobishëm për planifikuesit dhe vendimmarrësit (Duinker dhe Greig, 2007).

Skenari duhet të kuptohet si një parashikim i një situatë të caktuar, i përshkruar nga një sërë faktorësh të identifikueshëm në të tashmen tek të cilët provohet një projektion në të ardhmen, duke zgjedhur disa rezultate bindëse nga mundësitë e pafundme.

Qëllimi i një skenari në planifikimin territorial nuk është parashikimi i të ardhmes, por nxitja e një reflektimi mbi efektet e mundshme të ndryshimeve që mund të ndodhin:

- në një kontekst të veçantë ekonomik dhe social;

- në një kontekst afatgjatë ose afatmesëm;
- në lidhje me një territor dhe një mjedis të cilit i dihen kushtet kryesore aktuale.


Agjencia Evropiane e Mjedisit ka deklaruar në këtë mënyrë qëllimin e analizës në bazë të skenarëve: “Skenaret mjedisore, parashikimet dhe llojet e tjera të studimeve na ndihmojnë për të adresuar boshllëqet dhe paqartësitë e zhvillimeve të ardhshme dhe për të formuluar politika bindëse që do i rezistojnë testit të kohës “(EEA, 2009).

Të mendosh për të ardhmen do të thotë të mendosh përse i përket skenarëve të ndryshëm, të dëshirueshëm ose jo dhe në këto kushte VSM ka rolin e mbështetjes/bashkëpunimit në procesin e planifikimit, që nga hapat e parë të formulimit të një plani. Qëllimi i dytë është që të bëjë të qartë procesin e integritit të çështjeve mjedisore në plan, siç përcaktohet në Strategjinë e Goteborgut (2001), që parashikon integrimin e dimensionit social të zhvillimit, i përcaktuar në Strategjinë e Lisbonës, me aspektet e qëndrueshmërisë mjedisore .

Vlerësimi i skenarëve është shumë i dobishëm për identifikimin e treguesve kryesorë që kushtëzojnë agjentët transformues të mjedisit, rrjedhimisht evoluimin e vetë mjedisit, dhe për të patur një referencë për vlerësimin e ndryshimeve që ndodhin në fazën e monitorimit të planit në zbatim.

“Arsyetimi mbi skenarë” nuk i përket vetëm fazës së ndërtimit të strukturës së planit, por është gjithashtu shumë i dobishëm në ndërtimin e dokumenteve përshkruese të planit (linjat e veprimit, masat, rregullat e zbatimit ...) që sheh në anën e vlerësimit mjedisor qartësimin e alternativave dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë të tyre. Skenarët e prodhuar gjatë ndërtimit të planit do të jenë instrumente shumë të dobishme për monitorimin e zbatimit të vetë planit, nëpërmjet të cilive do të mund të evidentohen devijimet nga pritshmëritë fillestare.

Direktiva Evropiane e VSM-së nuk i referohet drejtpërdrejt skenarëve, por alternativave. Skenari është një mjet që shqyrton kontekstin në të cilin vepron planin, identifikon linjat kryesore të ndryshimit me kalimin e kohës dhe ndihmon planifikuesit dhe vendimmarrësit në formulimin e objektivave që duhen ndjekur: prandaj analiza e skenarëve bën pjesë në fazën e përkufizimit të objektivave. Programet ose planet alternative janë “të përbërë nga grupe të ndryshme të veprimeve, masave rregullatore, etj ...” (Enplan, 2004) që duhet të arrijnë objektivat e planifikuara të përcaktuara pikërisht nga analiza e skenarit (skenaret e përmendur më sipër); për këtë arsye, ata bëjnë pjesë në fazën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të linjave të veprimit të planit, zgjedhjes së veprimeve, masave dhe normave të planit. Në këtë kontekst, ai që gjithmonë duhet të merret parasysh është opsioni zero, në të cilin nuk ka veprime, masa dhe rregulla të përcaktuara të planit, pra në thelb është një “jo-alternativë”, që e mban të pandryshuar *status quo*-në duke përsh



- 1) Cili është problemi?
- 2) Ku duhet të shkojmë?
- 3) Si të shkojmë deri atje?
- 4) Si ta masim dhe modelojmë këtë?
- 5) Çfarë mund të ndodhë në kushtet e biznesit-si-zakonisht?
- 6) Cilët skenarë alternativ janë të mundshëm?

kruar prirjet e së ardhmes në mungesë të ndërhyrjeve dhe ndryshimeve sistematike.

Çdo alternativë është e përbërë nga tërësia e veprimeve dhe parametrave kryesore që karakterizojnë një proces të zbatimit të objektivave specifike të planit. Qëllimi është identifikimi i veprimeve më të përshtatshme për arritjen e objektivave të planifikuara. Ndërtimi i alternativave duhet të marrë parasysh një përzgjedhje paraprake të disa veprimeve, efektet e të cilëve nuk duhet të krijojnë kushtëzime reciproke negative, duke garantuar kështu një qëndrueshmëri të brendshme për linjën e veprimit. Vlerësimi i alternativave përfshin një analizë SWOT të ndikimeve, që nxjerr në pah pikat e forta, dobësitë, rreziqet e brendshme dhe të jashtme dhe mundësitë për secilën alternativë.

Kjo thekson se sa e rëndësishme është që skenarët dhe alternativat të kenë të njëjtin horizont kohor. Në fakt, një plan duhet zbatuar dhe mishëruar në një kontekst që vendoset brenda kufijve të caktuar nga vetë skenari; në qoftë se kjo nuk ndodh, duhet të bëhen korrigjime ose një rishikim i planit. Në këtë kontekst bëhet i domosdoshëm verifikimi i zbatimit të planit nëpërmjet monitorimit. Monitorimi është në fakt mënyra e përcaktuar nga legjislacioni për të lejuar vendimmarrësit të ndërhyjnë, kur një mjet i planifikimit nuk arrin të jetë efektiv. Edhe në këtë fazë të veçantë të procesit të VSM-së, analiza e skenarit është një mjet i vlefshëm për të kontrolluar devijimet në kohë në lidhje me skenarin e planit dhe për të vlerësuar gjendjen e marrëdhënieve ndërmjet objektivave, presioneve dhe gjendjen e burimeve.

3.3 Alternativat

Alternativa 0 – Trendi aktual i pandryshuar: I korrespondon skenarit që nuk realizohet asnjë ndërhyrje strategjike për përmirësimin e kushteve të mjedisit, që nënkupton situatën në Bashkinë e Durrësit në rastin kur trendi aktual i rritjes dhe zhvillimit nuk do të pësonte asnjë ndryshim. Projektimi i rritjes demografike tregojnë një rritje të pritshme vjetore të popullsisë rreth 22%. E cila do të sjell rritjen e kërkesës për vendbanime dhe shërbimeve të reja për popullsinë. Kjo përkthehet në mënyrë të drejtëpërdrejt në një shfrytëzim të tokave bujqësore dhe zonave të gjelbërta për qëllime ndërtimi. E cila përbën opsionin më pak të dëshirueshëm, me qenë se kjo linjë zhvillimi nuk parashikon rikuperimin e zonave të lira dhe bonifikimin e zonave të ndotura, të cilat do të lihensi një element degradues në përbërjen e Bashkisë së Durrësit. Në vend që të shfrytëzohen hapësirat e lira në brendësi të qendrave urbane, duke rritur dendësinë dhe duke e kompaktuar qendrën historike, do të shkohet drejt konfigurimit të një qyteti edhe më të përhapur në hapësirë, e karakterizuar nga një shpërndarje urbane e çrregullt. Efekte të tjera të lidhura ngushtë janë:

- Varësia më e madhe në transportin privat për shkak të rritjes së distancës nga

shërbimet dhe nga vendi i punës. I cili nuk ka ecur paralel me zgjerimin e rrjetit të transportit dhe ndërtimin e infrastrukturës së re për mjetet alternative të transportit, të tilla si korsi për biçikletat, trotuare dhe kalimet për këmbësorë;

- Rritja e trafikut të automjeteve dhe përkeqësimi i cilësisë së ajrit

Zona më problematike e parë nga pikëpamja urbane do të mbetet lagjia e Kënetës në Durrës, në të cilin do të ndërtohen ndërtesa të reja abuzive, me cilësisë të ulët arkitekture, të papërshtatshme nga pikëpamja e izolimit sismik-strukturor dhe termik / akustik. Ndërtesat do të shtrihen gjithmonë e më shumë në kufijtë e lagjes, në afërsi të venddepozitimeve të mbetjeve, që paraqesin probleme të mëdha sanitare.

Aktualisht çështja e mbeturinave përbën një nga problemet më të mëdha në të gjithë vendin: në Bashkinë e Durrësit venddepozitimet nuk janë në përputhje me standardet europiane dhe kontribuojnë në masë të madhe në ndotjen e mjedisit e matricës së ajrit, ujit dhe tokës. Rrjeti i grumbullimit të mbetjeve është tërësisht i pamjaftueshëm, aq sa mbetjet braktisen ose hidhen në rrjedhat ujore, dhe ende nuk ka filluar përhapja e grumbullimit të diferencuar. Rritja e popullsisë do të sjellë rritjen e prodhimit të mbetjeve urbane, dhe në mungesë të masave për të përmirësuar menaxhimin e tyre, ndotja e mjedisit do të rritet në mënyrë të konsiderueshme: venddepozitime të reja abuzive do të krijohen në zonat rurale në afërsi të qendrave të banuara dhe ato ekzistuese do të zgjerohen. Pa ndonjë program për zhvillimin e rrjetit të menaxhimit të mbetjeve dhe sigurimin e emetimeve të lëndëve të dëmshme, shëndeti i njeriut është në rrezik konstant.

Bregdeti i Durrësit, i cili tërheq turizmin lokal nga pjesët periferike të territorit gjatë sezonit të verës, do të jetë nën presion të vazhdueshëm rritës për shkak të shtimit të popullsisë: e cili do të sjellë vazhdimin e procesit të betonimizimit të brigjeve dhe ndërtimin e resorteve të mëdha duke sjellë humbjen e natyralitetit të vendit. Habitatet delikate natyrore të tilla si laguna do të zhduken, duke rezultuar në reduktimin e biodiversitetit

Ndotja e ujit të detit në afërsi të bregut do të pësojë një rritje të ndjeshme, si për shkak të shkarkimit të drejtpërdrejtë në det dhe pa trajtim të mbeturinave komunale dhe industriale, ashtu edhe nga mbeturinat të transportuara nga lumenjtë.

Një problem të madh sanitar do të përbëj rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, që do të jetë rezultojë i pamjaftueshëm siç është ende sot, për numrin e banorëve në rritje progresive. Nëse nuk do të kushtohet vëmendje mirëmbajtjes në kohë, nuk do të zëvendësohen pjesët e rrjetit të vjetëruara dhe nuk do të implementohen masat e nevojshme për të menaxhuar rritjen e fluksit të ujërave të zeza komunale, do të shohin një përkeqësim të mëtejshëm të cilësisë së ujit dhe tokës.

Rritja ekonomike do të nxitet nga industria: hapja e impianteve të reja të prodhimit do të ketë ndikim të konsiderueshëm në mjedis, nëse këto të fundit nuk marrin masat e duhura të kontrollit dhe reduktimin e emetimeve të dëmshme në atmosferë, e cila në ditët e

sotme nuk është në përputhje me standardet europiane.

Alternativa 1- Zgjidhja e planit: Skenari i Planit është ai që rezulton më i qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore. Një sërë masash strategjike, që do të zbatohen në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë, në varësi të prioriteteve, do të mundësojë një kthesë në shfrytëzimin aktual të pakontrolluar të resurseve natyrore.

Logjika e zhvillimit të qëndrueshëm përbën bazën e të gjitha zgjedhjeve për përmirësimin e menaxhimit të tokës, veçanërisht në lidhje me:

- zhvillimin urban
- sistemi Infrastrukturor;
- menaxhimi i mbetjeve urbane dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ;
- mbrojtja e zonave bregdetare dhe habitateve natyrore (biodiversitetit);
- menaxhimi i rrjedhave ujore dhe baseneve ujore sipërfaqësore

Pjesa më e madhe e masave vepruese do shërbejnë për zbutjen e ndotjes së mjedisit, pa kompromentuar zhvillimin ekonomik, në mënyrë që të arrijnë nivelet sipas standardeve europiane. Objektivi kryesor është për ti dhënë qytetarëve një mjedis të shëndetshëm në të cilën mund të jetojnë, të këndshëm dhe duke përmbushur kriteret e shërbimeve të ofruara për popullsinë. Kjo rrjedhimisht shkon në të mirë të turizmit lokal, i cili do të mbështetet nga strukturat e duhura dhe do të nxisë përmirësimin e mëtejshëm.

Qyteti i Durrësit do të jetë më së shumti nën ndikimin e presionit demografik, duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm të luajtur nga porti dhe përmirësimin e rrjeteve të transportit që e lidhin me Kryeqytetin. Strategjia themelore për të menaxhuar rritjen e pritshme të popullsisë është që të “mbushen” hapësirat bosh urbane, rikuperohen zonat e braktisura dhe të degraduara: në vend që të zgjerohet qyteti në drejtim të periferisë, duke favorizuar “zgjerimin” urban dhe lindja e periferive të reja, ygjdhja e planit parashikon ruajtjen e shtrirjes aktuale të qytetit dhe rritjen e densitetit të tij. Përdorimi i tokës është në fakt një parametër shumë i rëndësishëm për të gjykuar qëndrueshmërinë e një plani, sepse është në përpjesëtim të zhdrejtë me këtë të fundit. Dhe sigurisht zgjidhja optimale, edhe pse ekonomikisht më pak e dobishme, rehabilitimin dhe rikuperimi i zonave të braktisura, në vend të shfrytëzimit të fushave të reja të pazhvilluara, duke ja hequr bujqësisë. Në këtë mënyrë zhvillimi urban do të jetë shumë më i kontrolluar, nuk do të krijojë periferi të reja që do të sjellin nevojën e lidhjes me qendrën me infrastrukturë të kushtueshme dhe të shpërndarë.

Ofrimi i shërbimeve të tilla si furnizimi me ujë, energji elektrike dhe rrjeti i kanalizimeve në zonat me popullsi të dendur në fakt është shumë më pak i kushtueshëm dhe më i qëndrueshëm në krahasim me zonat më pak të populluara. Gjithashtu duhet të konsiderohet se edhe rritja e hapësirës së zënë nga infrastruktura zvogëlon sasinë e tokës së

depërtueshëm, dhe rrjedhimisht niveli i ujit në akuiferet.

Paralelisht me rritjen e qytetit të Durrësit në aspektin e ndërtimeve të reja dhe restaurimit të ndërtesave / lagjeve, infrastruktura të tilla si kanalizime e ujërave të zeza dhe të rrjetit të furnizimit me ujë duhet të përshtatet dhe rritet në kapacitet për të shërbyer në mënyrë të përshtatshme rritjes së popullsisë. Në mënyrë të veçantë shumë e rëndësishme do të jetë trajtimi i ujërave të zeza komunale para shkarkimit në det. Për këtë qëllim, impianti ekzistues i trajtimit (WWTP) do të dyfishohet ose trefishohet sipërfaqen e tij. Në qytetet më të vogla do të bëhen mini rrjete kanalizimesh kurse në zonat e largëta do të vazhdojë të përdoret sistemi ekzistues i gropave septike, me futjen e teknikave moderne të sistemeve nëntokësore.

Numri i banorëve të Durrësit do të shtohet në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e rritjes së pritshme demografike, si dhe migrimi i popullsisë nga periferia për shkak të mundësive të punësimit të ofruara nga qyteti kryesor. Megjithatë, në sajë të masave për të mbështetur bujqësinë dhe zhvillimin e zonave rurale, nuk do të haset shpopullimi i fshatrave, në të cilat zhvillohen tregjet lokale dhe shërbime të reja. Sigurisht industria do të mbetet sektori kryesor i ekonomisë së Durrësit, por edhe bujqësia do të ketë një rol kyç duke ofruar vende të reja punësimi.

Menaxhimi i mbetjeve urbane do të përgjigjet standardeteve europiane, si rrjedhojë do të sjellë përfitime në shëndetin e njeriut: venddepozitimet do të jenë higjienizuar dhe rehabilituar, do të ngihet një sistemi efikas grumbullimi i mbetjeve, i cili do të mundësojë trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve të rrezikshme, si dhe rikuperimin e fraksioneve organike të cilat do të ripërdoren si pleh organik.

Në periudhën afatmesme dhe atë afatgjatë do të kryhet pastrimi i lumenjve dhe rezervuarëve, me sistemimin e shpateve, shtretërve dhe përforcimin e argjinaturave. Sidomos në afërsi të grykderdhjes së Lumit Erzen, ku ndodhin më shpesh përmbajtje si pasojë e daljes së lumit nga shtrati, për zgjidhjen e kësaj problematike do të ndërtohen brigje për pritjen e sasisë maksimale të prurjeve të lumit. Ndërtimi i një argjinature të dytë mbrojtëse në rrethinat e fshatrave dhe zonave të banuara, si dhe mbjellja e disa llojeve drusor për të siguruar një “zonë tampon” në mënyrë që të parandalohet përparimi i prurjeve ujore, do të ndihmojnë për të mbrojtur zonat e rrezikuara më shumë nga përmbajtjet.

Industritë e reja do të ndërtohen në zonën ekonomike Spitallë ngjitur me Porto Romanon, të përqendruar në një zonë të vetme me objektive të identifikuar si “prodhuese”. Vendndodhja e qendrës së prodhimit në afërsi të portit dhe Impiantit Energjitik do të lejojë përqendrimin e të gjitha shërbimeve të nevojshme për industrinë dhe një lidhje të drejtpërdrejtë me transportin detar dhe atij tokësor në drejtim të Tiranës. Kjo e fundit do të realizohet nga zgjerimi i autostradës si dhe linjës hekurudhore Tiranë-Durrës deri në Porto Romano.

Përmirësimi i rrjetit rrugor dhe hekurudhor të transportit do të lehtësojë edhe transferimin e mallrave nga një qytet në tjetrin, si dhe zhvendosjen e banorëve në rajon, reduktimin e trafikut. Në veçanti, autostrada Durrës-Tiranë do të jetë e pajisur me korsin për shpejtim-ngadalësimin në hyrje dhe dalje, korsin emergjence dhe zonën ndalimi, duke e bërë atë shumë më të sigurt. Linja hekurudhore, e cila aktualisht është vetëm një korsin do të rritet në dy korsin dhe trenat do të modernizohen, duke reduktuar në mënyrë drastike kohëzgjatjen e udhëtimit. Ndërtimi i stacioneve të vogla të ndërmjetme përgjatë linjës Tiranë-Durrës dhe Durrës-Kavajë do të lejojë qarkullimin nga rrethinat drejt bregdetit dhe përgjatë saj, duke ulur përdorimin e makinave private e cila favorizon përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Regresi i bregdetit është një problem që shqetëson aktualisht shumë pjesë të rivierës së Bashkisë së Durrësit, në veçanti Gjirin e Lalzit. Fenomeni është i pakthyeshëm, por ajo mund të parandalohet nga një seri ndërhyrjesh që synojnë:

- ndalimi i nxjerrjes së pakontrolluar të zhavorrit nga lumenjtë, që varfërojnë shtratet e lumenjve dhe si rrjedhojë zvogëlojnë prurjet e sedimenteve në grykderdhje;
- Ndërtimi i mundshëm në det i veprave si diga apo panele të zhytura, nëse masat e zbatuara në rrjedhën e sipërme të lumit nuk përbëjnë ulje të konsiderueshme në kohë dhe sjellin regresin të vijës së bregdetit.

Së bashku me këto ndërhyrje, mbushje sistematike e zonave më të prekura nga ky fenomen, dhe rikompozimi i dunave të zhdukura, mbjellja e pemëve tipike e këtij habitati, do të lejojë që në vitet ardhshëm plazhi do të fitojë terren, duke ju kthyer hapësirat publike popullsisë.

Problemi i erozionit dhe gërryerjes së shpateve do të zgjidhen pjesërisht nëpërmjet rryllëzimit të zonave të shpyllëzuara, sistemimi i shpateve më të rrezikuara nga veprimi hidrogeologjik dhe realizimi i veprave për të mbajtur sedimentet në rrjedhën e sipërme. Rregullimi i zonave kodrinore nëpërmjet sistemimit të taracave të vjetra të dedikuara për kultivimin e ullishteve dhe vreshtave, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i rrëshqitjeve të tokës dhe paralelisht do të japë një nxitje të mirë për sektorin e bujqësisë

Vihet re se pjesa më e madhe e ndërhyrjeve të çojnë në skenarin e propozuar të planit, që do të thotë të ketë një ndikim pozitiv, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale të mjedisit dhe uljen e shkaktarëve kryesorë të ndotjes. Për këtë arsye, skenari i planit është identifikuar si i mundshëm dhe më optimal.

Alternativa 2: Një skenar që mund të imagjinohet duke vërejtur shkallën e rritjes aktuale ekonomike të cilin i përket një metropoli që rritet përgjatë rrugës që lidh Durrësin dhe kryeqytetin Tiranë.

Është një prirje që tashmë ka ndodhur pjesërisht në vitet e fundit, me ngritjen e aktiviteteve prodhuese përgjatë kësaj rruge. Autostrada përfaqëson rrugën më të shpejtë të lidhjes së Durrësit, portit më të madh të vendit dhe kryeqytetit të Tiranës. Dy polet katalizatorët e veprimtarive ekonomike do të jetë gjithnjë e më të lidhura gjatë viteve që do të vijjnë, duke marrë parasysh potencialin e rritjes së Shqipërisë në të ardhmen e afërt dhe shkëmbimin e energjisë ndërmjet dy qendrave që gjithmonë e më shumë do të vijë duke u forcuar.

Sigurisht skenari i një qyteti metropolitan pa ndërprerje, të zhvilluar në të dyja anët e një autostrade, e cila në fakt është me dy korsi, nuk është alternativë e mirë për të ardhmen. Së pari duhet të konsiderohet që infrastruktura ekzistuese rrugore nuk është e mjaftueshme për të trajtuar flukset e mëdha të trafikut. Edhe në qoftë se do të ndërhyhet në shtimin e kapaciteteve të rrjeteve, trafiku është shkaktari kryesorë i ndotjes së ajrit, dhe për pasojë do të mbetet një problem i vështirë për tu zgjidhur. Nëse do të zhvillohet linja hekurudhore, duke e bërë atë nga një korsi deri në të paktën dy korsi, me siguri do të vërehet një reduktim i trafikut, edhe pse makina do të mbetet mjete më i preferuar i transportit për njerëzit të cilët do të duhet të udhëtojnë në distanca të mëdha për të arritur vendin e punës apo shërbimet kryesore të tilla si shkolla, spital dhe qendra tregtare.

Është gjithashtu e qartë se transportit i mallrave në rrugë automobilistike nuk mund të zëvendësohet në tërësi nga ai në linja hekurudhore, pasi deri më sot ai i rrugëve automobilistike është ende më i përshtatshëm nga pikëpamja ekonomike. Përveç kësaj, duke siguruar transportin hekurudhor me shpejtësi të lartë për mallrat dhe për pasagjerët, dhe duke synuar një intermodalitetin virtuoz mes trenave, arrihet transporti për distanca të mëdha i mallrave, dhe i lihet kamionit distancat e shkurtra për shpërndarje, në këtë mënyrë trafiku do të reduktohet, por gjithsesi do të dynden rrugët, sidomos në pikën e hyrjes së qytetit që është një nga nyjet rrugore e pamjaftueshme për të një zgjidhje të mirë programuar.

Ndotja e prodhuar nga kamionat është shumë më e madhe se ajo e makinave dhe sidomos nëse krahasohet me trenin, i cili është mjete më miqësor ndaj mjedisit. Mjafton të krahasohet se për çdo ton mallrash të transportuar me një tren europian mallrash për kilometër, në atmosferë emetohen mesatarisht 29 gram CO₂, ndërsa për çdo kamion Euro 5, nga ana tjetër, emetime arrijnë në 81 gram, gati trefishi më shumë.

Duke marrë parasysh se në të kaluarën janë gjetur mbetje fikse të metaleve të rënda mbi mesataren e “tolerueshme”, në qumështin e nënave me fëmijë të sapolindur të cilët jetojnë në zona malore, ku bëhet kalimi më i shpeshtë kamionëve, ne e kuptojmë se si ndotja e ajrit nga shkarkimet e kamionëve paraqet një problem serioz për shëndetin e njeriut. Gjithashtu duhet të konsiderohet se Tir konsumojnë sipërfaqen e asfaltit të rrugëve një mijë herë më shumë se kalimi i një makine, duke e sjellë një kërkesë për mirëmbajtje më të shpeshtë, që rezulton në kosto të konsiderueshme për shoqërinë.

Nëse qyteti metropolitan në njërin anë ka avantazhin e lëvizshmërisë së shpejtë nga një qytet në tjetrin, nëpërmjet rrugës kryesore, nga ana tjetër përbën në fakt llojin “e

përhapur” urban, e cila përfshin përdorimin më të madh të tokës dhe shtrirjen e rrjeteve hidraulike dhe elektrike në shërbim të qendrave të reja të banuara. Për më tepër, përqendrimi i investimeve në aksin Tiranë-Durrës nuk inkurajon qarkullimin e tërthortë dhe as atë në drejtimin veri-jug, të cilat do të sjellin gjithmonë e më shumë izolimin e fshatrave, që do të përjashtohen nga zhvillimi dhe si pasojë do të mbeten të prapambetura. Shpopullimi i zonave rurale do të jetë pasojë e pashmangshme e këtij procesi, pasi popullsia do të tërhiqet gjithnjë e më shumë nga mundësitë e ofruara nga qyteti metropolitan.

Megjithatë, kjo e fundit do të zhvillohet në mënyrë të shpërndarë, pa një qendër “kompakte” me uniformitet të njohur të karakteristikave arkitektonike. Qyteti do të karakterizohet nga ndarja fizike e hapësirës së përdorur për aktivitete të ndryshme: banimi, qendër tregtare, zyra, institucione qytetare, dhe rrugëve:

- Zonat e banuara do të përbëhen nga territore të mëdha me ndërtime të reja, identike në formë, ngjyra dhe materiale. Pemët dhe vegjetacioni ekzistues do të çrrënjosen dhe të zëvendësohen, duke i bërë rrugët e lagjeve pa gjelbërim dhe boshe. Kjo do të ndodhë sidomos në ato zona që më parë kanë qenë fshatra. Shtëpitë, me vlerë të vogël arkitektonike dhe shpesh jo të ndërtuara mirë, që i përgjigjen vetëm sensit praktik, jo normativave që imponojnë projektimin optimal që sjell kursim të energjisë dhe shpesh këto projektohen nga ndërtuesi dhe jo nga ekspertë profesional në fushën e projektimit, si arkitektë dhe inxhinierë;
- Qendrat tregtare periferike shpesh shtrihen në një nivel dhe janë projektuar që të arrihen vetëm me makinë. Është e rrallë të gjendet një qendër tregtare pranë një zonë banimi, duke ditur që shumë njerëz preferojnë të jetojnë larg saj.
- Ndërtesat-Zyra janë vende të krijuara ekskluzivisht për kompanitë që ndërtojnë vendet e tyre të punës, përgjithësisht zyra, dhe zakonisht gjenden të izoluar nga pjesa tjetër e funksioneve urbane.

Në lagjen tradicionale pozicionimi i afërt me vendin e punës, hapësirat e restoranteve dhe pazareve gjatë ditës është një komponent thelbësor për bilancin e jetës urbane. Përveç kësaj, afërsia e vendit të punës me zonën e banimit jep mundësinë e qarkullimit në këmbë ose me biçikletë. Në rastin e distancave të mëdha të zonave të banimit me vendin e punës apo shërbimeve kryesore të dobishme për popullatën do të vendosë përdorimin masiv të makinave, me përkeqësimin e pashmangshëm të cilësisë së ajrit.

Ndërtesat publike si bashkia, bibliotekat, shkollat, kishat dhe teatrot në lagjen tradicionale përbëjnë një rëndësi të veçantë në nivelin e komunitetit, të aksesueshme nga të gjithë, dhe shpesh të vendosura në pikat kryesore të qytetit. Në qytetin shpërndarë shkollat dhe kishat, për shembull, janë të pozicionuara në zonat kufitare të komunitetit dhe të rrethuara nga parking.

Avantazhi që paraqet qyteti linear konsiston me faktin se objektet e reja janë të përqend-

ruara përgjatë aksit Tiranë-Durrës, si rrjedhojë bregdeti do të ndikohet në një masë më të vogël nga zhvillimi dhe kështu do të ruhet më shumë nga mbindërtimi, dhe naturalitetit të atyre zonave të paprekura nga betonizimi.

Si përfundim, skenari alternative përfaqëson më pak përfitime dhe shumë probleme të konsiderueshme: nga njëra anë zhvillimi i infrastrukturës do të lejojë udhëtimin më të shpejtë dhe të sigurt, si dhe rritja e qytetit përgjatë rrugës do të lehtësojë qarkullimin e mallrave dhe njerëzve përgjatë boshtit lindje-perëndim, nga ana tjetër do të rrisë ndotjen e ajrit, shtrirjen urbane dhe përdorimin e tokës, dhe nuk do të zgjidh çështje të tjera mjedisore me të cilat ballafaqohet bashkia e Durrësit.

3.3 Analiza SWAT

Nëpërmjet analizës SWOT mund të zbulohen pikat e forta dhe të dobëta të secilit skenar alternativ të zhvillimit në konsiderim, në mënyrë që të dalin ato aftësi favorizuese, ose të pengojnë ose vonojnë ndjekjen e objektivave të planit. Më konkretisht, në analizën SWOT veçohen faktorët endogjen dhe ekzogjen.

Faktorët endogjen janë të ndarë në **pika të forta** dhe **pika të dobëta**; faktorët ekzogjene në mundësitë dhe rreziqet. Ndër të parët konsiderohen të gjithë ata variabla që janë pjesë përbërëse e sistemit, mbi të cilët mund të ndërhyet për të ndjekur objektivat. Ndër të dytët, megjithatë, përfshihen variabla jashtë sistemit, por që mund ta kushtëzojnë si pozitivisht ashtu edhe negativisht. Në rastin e fundit nuk mund të ndërhyet direkt në dukuri, por është i nevojshëm krijimi i sistemeve të kontrollit për të ndjekur agjentët ekzogjene dhe analizuar evolucionin për të parandaluar ndodhitë negative dhe për të përfituar nga ato pozitive.

Efektiviteti i kësaj metode të hetimit varet, ç'është më e rëndësishmja, në aftësinë për të bërë një lexim të "kryqëzuar" të të gjithë faktorëve të identifikuar në momentin në të cilin përcaktohen politikat. Është e nevojshme, në fakt, mbështetja në pikat e forta dhe zbutja e difekteve për të maksimizuar mundësitë dhe minimizuar rreziqet.

Si vijim sigurohet një përkufizim i përmblodhur, por rigoroz me përbërësit e analizës SWOT, të aplikuar në alternativat e identifikuara për bashkinë e Durrësit:

- **Pikat e forta** (*Strengths*). Përbërësit endogjen ose karakteret e sistemit lokal që ofrojnë perspektiva (madje edhe të mundshëm) të zhvillimit dhe përmirësimit të situatës aktuale socio-kulturore;
- **Pikat e dobëta** (*Weaknesses*). Përbërësit endogjen ose karakteret e sistemit territorial që përfaqësojnë mangësitë e strukturës së tij ekonomike, sociale dhe territoriale, ose pengesa në proceset e zhvillimit;
- **Mundësitë** (*Opportunities*). Rrethana endogjene ose, më shpesh, ekzogjene, të cilat mund të kultivohen dhe vlerësohen nga politikat e duhura për të fuqizuar

pikat e forta dhe zvogëlimin e ndikimeve negative të pikave të dobëta dhe për të aktivizuar apo përforcuar proceset e zhvillimit;

- **Rreziqet** (*Threats*). Rrethana endogjene ose, më shpesh, ekzogjene ose tendenca të sistemit lokale, të cilat mund të dobësojnë pikat e forta, të përkeqësojnë pikat e dobëta, të pengojnë kapjen e mundësive dhe të vënë rrezik proceset e zhvillimit.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur elementet kritik të veprimeve që merren në konsideratë për sektorin e lëvizshmërisë, për të siguruar një pasqyrë të përmbledhur të mundësive dhe problemeve të zhvillimit të sistemit infrastrukturor, nga e cila të rrjedhin zgjedhjet e planifikimit.

Në faqen
pasardhëse
Tabela 3.1
Matrica SWOT
për vlerësimin
e skenareve të
ndryshëm të
planit

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË (TË JASHTME)	RREZIQET (TË JASHTME)
Alternativa 0			
<ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi ekonomik i shpejtë; 	<ul style="list-style-type: none"> Zgjerimi Urban; Humbja e vlerave të tokës; Rritja e trafikut dhe përqendrim të cilësisë së ajrit; Rrjeti I pamjaftueshëm I grumbullimit të mbeturinave; Numri i lartë i shkarkimeve të paligjshme nën standardet evropiane; Kanalizimi dhe furnizimi i pamjaftueshëm me ujë; Shfrytëzim i madh i bregdetit; 		<ul style="list-style-type: none"> Përkeqesimi i kushteve të përgjithshme mjedisit; Humbja e habitateve natyrore dhe biodiversitetit; Përkeqësimi dhe degradimi i Kenetës; Shtimi i kostove të komunitetit si pasojë e nevojës për shtimin e rrjetit hidraulik dhe elektrik Rreziqet e shëndetit të njeriut që lidhen me rritjen e ndotjes së matricave të ajrit, ujit, tokës; Ndërtesa me kosto të ulët, cilësi të dobët arkitektonike dhe materiale, pa marrë parasysh karakteristikat e izolimit akustik, termik dhe sizmitetit të terrenit.

Alternativa 1			
<ul style="list-style-type: none"> Rritja e dendësisë së popullsisë; Rikualifikimi i lagjeve/objekteve të degraduara nëpërmjet rikuperimit të hapësirave boshe në brendësi të qytetit; Pajisja me qendra të reja shërbimi në funksion të banorëve; Nxitja e sektorëve të bujqësisë Rritja e kapacitetit të autostradës dhe linjës hekurudhore Durrës-Tiranë; Rritja e kapacitetit i rrjetit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit të ujërave të zeza; Menaxhimi inteligjent i mbetjeve, nëpërmjet mbledhjes së diferencueshme dhe ripërdorimi i mbetjeve organike si pleh për bujqësinë; Bonifikimi i shkarkimeve abuzive; Përqëndrimi i industrive të reja në afërsi të vendprodhimit të pozicionuar në afërsi të Porto Romanos; Pastrimi i lumenjve dhe të shtreterve të tyre nga mbetjet urbane, bonifikimi i zonave të ndotura; Krijimi i shtreterve më të thella për parandalimin e përmytjeve dhe përforcimi i argjinaturave; Nxitja e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme; 	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e ndotjes akustike në qendrën e qytetit të Durrësit; Rritja e ndotjes në afërsi të Porto Romanos, aty ku do të përqëndrohen aktivitetet e reja prodhuese. 	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i kushteve të përgjithshme mjedisore; Më pak probleme që ndikojnë shëndetin e njeriut për pasojë të ndotjes së mjedisit; Ulja e fluksit nëpër rrugët me trafik më të dendur(aksi Tiranë-Durrës); 	

Alternativa 2			
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e kapacitetit të linjës rrugore Durrës-Tiranë dhe lehtësimin e qarkullimit; • Shfrytëzim më i vogël i infrastructures rrugore të rivierës. 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtrirja urbane; • Mungesa e një qendre urbane kompakte dhe e identifikueshme; • Ulja e vlerave të tokës; • Rritja e trafikut dhe si pasojë përkeqësimi i cilësisë së ajrit; • Rrjet i pamjaftueshëm për grumbullimin e mbetjeve urbane; • Numër më imadh i pikave të grumbullimit me mbetje abuzive poshtë standarteve europiane; • Rrjet i pamjaftueshëm për furnizimin me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza. 		<ul style="list-style-type: none"> • Përkeqësimi i kushteve të përgjithshme të mjedisit; • Humbja e habitateve natyrore dhe biodiversitetit; • Kosto më të larta për komunitetin si pasojë e nevojës së shtrirjes më të madhe të rrjeteve hidraulike dhe energjitike; • Rreziqe për shëndetin e njeriut të lidhura me rritjen e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës; • Ndërtimi i objekteve me kosto të ulët, cilësi të dobët arkitektonike dhe konstruktive, pa marrë në konsideratë kriteret e izolimit termik dhe atij sizmik.

4 Objektivat e mbrojtjes mjedisore

Siç është përmendur në § 3.1.1, pas matjes së qëndrueshmërisë së planit të propozuar në lidhje me objektivat e përcaktuara të qëndrueshmërisë mjedisore, do t'i referohet në mënyrë të veçantë treguesve/objektivave të përcaktuara në Manualin e DG XI të Komunitetit Evropian, zhvilluar për VSM-në e Planeve të Zhvillimit Rajonale dhe Programeve të Fondeve Strukturore të BE-së. Kriteret janë të renditur dhe të grupuara në 10 treguesit/objektivat, të ilustruar në tabelën e mëposhtme, secili prej të cilëve është nën-ndarë në kritere më të detajuar.

Tabela 4.1
Identifikimi i
objektivave të
qëndrueshmërisë mjedisore
dhe prioritetet

Tregues/objektiv i qëndrueshmërisë	Përshkrim
1. Zvogëlimi i përdorimit të burimeve të parinovueshme	Përdorimi i burimeve jo të rinovueshme, siç janë lëndët djegëse fosile, vendburimet minerare dhe inerte, redukton burimet në dispozicion për gjeneratat e ardhshme. Një nga parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm është një përdorim i arsyeshëm dhe ekonomik i këtyre burimeve jo të rinovueshme, duke respektuar normën e interesit që nuk përjashton mundësitë e rezervuara për brezat e ardhshëm. I njëjti parim duhet të zbatohet edhe për karakteristikat apo elementet gjeologjike, ekologjike dhe peizazhistike, unike në llojin e tyre dhe të pazëvendësueshme, të cilat kontribuojnë në aspektin e produktivitetit, biodiversitetit, dijes dhe kulturës shkencore (KMJ. gjithashtu edhe kriteret nr. 4 , 5 dhe 6).
2. Përdorimi i burimeve të rinovueshme brenda kufijve të mundësive të ripërtëritjes	Kur përdoren burimet e ripërtëritshme në aktivitete prodhuese kryesore të tilla si në pylltari, bujqësi dhe peshkim, çdo sistem ka rendiment maksimal të qëndrueshëm, përtej të cilit burimet fillojnë të degradojnë. Kur atmosfera, lumenjtë, estuaret dhe detet përdoren si “rezervuarë” për mbeturinat, ato trajtohen si burime të rinovueshme, në kuptimin që bazohen në aftësinë e tyre të natyrshme për t’u ripërtërirë: në rast të mbishfrytëzimit të aftësive të tilla, do kalohet në degradimin e burimeve në planin afatgjatë. Pra duhet theksuar rëndësia e përdorimit të burimeve të rinovueshme në një normë të tillë që të jenë në gjendje të rigjenerohen në mënyrë të natyrshme, duke siguruar kështu ruajtjen apo edhe rritjen e rezervave në dispozicion për brezat e ardhshëm.
3. Përdorimi në mënyrë të vlefshme në kontekstin ambiantal i substancave dhe mbetjeve të rrezikshme për mjedisin	Në shumë situata është i mundur përdorimi i substancave më pak të dëmshme për mjedisin dhe shmangia ose reduktimi i prodhimit të mbetjeve, veçanërisht mbetjeve të rrezikshme. Ndër objektivat e një qasjeje të qëndrueshme është përdorimi i materialeve që kanë ndikimin më pak të dëmshëm të mundshëm në mjedis dhe prodhimin minimal të mbetjeve. Këto bëhen të arritshme nëpërmjet sistemeve të projektimit të procesit, menaxhimit të mbeturinave dhe zvogëlimit të ndotjes.

Tregues/objektiv i qëndrueshmërisë	Përshkrim
4. Ruajtja dhe përmirësimi i gjendjes së florës dhe faunës së egër, habitateve dhe peizazheve	Në këtë kontekst, parimi themelor është ruajtja dhe pasurimi i rezervave dhe cilësisë së burimeve të trashëgimisë natyrore në mënyrë që gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme të mund të përfitojnë prej tyre. Ndër burimet e trashëgimisë natyrore përfshihen flora dhe fauna, karakteristikat gjeologjike dhe fiziologjike, bukuritë natyrore dhe në përgjithësi burimet e tjera mjedisore me karakter rekreativ. Në trashëgiminë natyrore, pra, bëjnë pjesë topografia, habitatet, flora dhe fauna e egër dhe peizazhet, por edhe kombinimet dhe përsëritjet ndërmjet tyre dhe potenciali rekreativ që paraqesin; nuk duhen harruar lidhjet e ngushta me trashëgiminë kulturore (KMJ, kriteri nr. 6)
5. Ruajtja dhe përmirësimi i tokës dhe pasurive hidrike	Toka dhe burimet hidrike janë burime natyrore të ripërtëritshme, të domosdoshme për shëndetin dhe mirëqënien e njerëzve, por mund të pësojnë humbje për shkak të nxjerrjes, erozioneve ose ndotjes. Parimi bazë që duhet të ndiqet për këtë arsye është mbrojtja e burimeve ekzistuese si nga ana e cilësisë ashtu dhe e sasisë dhe përmirësimi i burimeve tashmë të degraduar.
6. Ruajtja dhe përmirësimi i trashëgimisë historike dhe kulturore	Trashëgimia historike dhe kulturore përbëhet nga burime të fundme që nëse të shkatërrohen ose dëmtohen, nuk mund të zëvendësohen. Ashtu si me burimet jo të rinovueshme, parimet themelore të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm kërkojnë që të ruhen të gjitha karakteristikat, qendrat apo zonat në procesin e rinovimit, që janë përfaqësues të një periudhe të caktuar, ose që japin një kontribut të veçantë në traditat dhe kulturën e një zone. Lista përfshin ndërtesat me vlerë historike dhe kulturore, strukturat e tjera apo monumentet e çdo epoke, gjetjet arkeologjike akoma të pazbuluara, arkitekturën e jashtme (peizazhe, parqe dhe kopshte) dhe të të gjitha objekteve që kontribuojnë në jetën kulturore të një komuniteti (teatro, etj). Edhe stili i jetesës, zakonet dhe gjuhët tradicionale, bëjnë pjesë në trashëgiminë historike dhe kulturore që mund të jetë e vlefshme për t'u ruajtur.
7. Ruajtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit lokal	Si pjesë e kësaj analize të cilësisë së mjedisit lokal merret edhe cilësia e ajrit, niveli i ndotjes akustike të mjedisit, impakti vizual dhe elemente të tjera estetike të përgjithshme. Cilësia e mjedisit lokal është e një rëndësie të madhe në zonat dhe vendet e banuara, aty ku ndodhin një pjesë e mirë e aktiviteteve të kohës së lirë dhe punës. Cilësia e mjedisit lokal mund të pësojë ndryshime drastike, si pasojë e ndryshimeve të aktivitetit industrial, të ndërtimit apo aktiviteteve minerare, nga përhapja e ndërtesave dhe infrastrukturës së re dhe nga rritja e përgjithshme e aktiviteteve si ato turistike, etj. Është gjithashtu e mundur t'i jepet një goditje e fortë një mjedisi lokal të dëmtuar nga futja e një zhvillimi të ri. Shih edhe kriterin 3 mbi reduktimin e përdorimit dhe përhapjes së substancave ndotëse.

Tregues/objektiv i qëndrueshmërisë	Përshkrim
8. Mbrojtja e atmosferës në shkallë globale dhe rajonale	Një nga forcat kryesore përgjegjëse për shfaqjen e zhvillimit të qëndrueshëm është e përbërë nga të dhëna që vërtetojnë ekzistencën e problemeve globale dhe rajonale të shkaktuara nga emetimet në atmosferë. Lidhjet midis emetimeve nga djegia, shiu acid dhe acidifikimi i tokave dhe ujërave, si dhe nëpërmjet klorofluorkarbureve(CFC), shkatërrimi i shtresës së ozonit dhe efektet në shëndetin e njeriut janë indentifikuar në vitet shtatëdhjetë dhe në fillim të viteve tetëdhjetë. Rrjedhimisht është zbuluar më pas lidhja mes dioksidit të karbonit dhe gazeve të tjera serrë me ndryshimet klimatike. Bëhet fjalë për pasoja afatgjata dhe të përhapura, që paraqesin një kërcënim serioz për brezat e ardhshëm. Shih edhe kriterin 3 mbi reduktimin e përdorimit dhe përhapjes së substancave ndotëse.
9. Zhvillimi i ndjeshmërisë, udhëzimeve dhe trajnimit në fushën mjedisore	Pjesëmarrja e të gjithë partnerëve ekonomik për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm është një element bazik i parimeve të vendosur në konferencën e Rios për mjedisin dhe zhvillimin (1992). Për të realizuar një zhvillim të qëndrueshëm është thelbësor ndërgjegjësimi për temat dhe mundësitë e disponueshme; elemente po aq të rëndësishëm janë informacionet, udhëzimet e trajnimit në lidhje me menaxhimin mjedisor. Një objektiv i tillë mund të arrihet nëpërmjet publikimit të rezultateve të kërkimit, duke shtuar programe në fushën mjedisore në nivel trajnimi profesional, në shkolla, në universitete apo në programet për trajnimin e të rriturve dhe duke krijuar rrjete brenda sektorëve dhe grupime ekonomike. Së fundi duhet kujtuar rëndësia e aksesit të informacionit në fushën mjedisore nga vendbanimi ose nga vende rekreacioni.
10. Promovimi i pjesëmarrjes së publikut në vendimet në fushën e zhvillimit	Deklarata e Rios (Konferenca e Rios për mjedisin dhe zhvillimin, 1992) vendos, midis themeleve të zhvillimit të qëndrueshëm, që publiku dhe palët e interesuara përfshihen në vendimet që kanë të bëjnë me interesat e tyre. Mekanizmi kryesor është konsultimi publik në fazën e kontrollit të zhvillimit dhe në veçanti përfshirja e të tretëve në vlerësimin mjedisor. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm parashikon një përfshirje më të gjerë të publikut në përpunimin dhe zbatimin e propozimeve të zhvillimit, që duhet të lejonte zhvillimin e një sensi më të madh të pronësisë dhe ndarjes së përgjegjësisë.

Përputhshmëria më e madhe apo më e vogël e planit të propozuar me këta kriterë është padyshim një përfaqësim i mirë i qëndrueshmërisë më të lartë apo më të ulët.

Në tabelën në vazhdim janë vënë në marrëdhënie veprimet kryesore të planit me kriteret e qëndrueshmërisë, të identifikuar nga Komiteti Evropian (DG Mjedisi) për të vlerësuar qëndrueshmërinë e zgjedhjeve të planit dhe kështu, më në përgjithësi, të vet planit (cd. verifikimi i koherencës “së jashtme”). Për të thjeshtësuar leximin, veprimet strategjike janë grupuar sipas fushave të cilave u referohen:

1. Mbetjet;

2. Uji;
3. Transporti;
4. Ekonomia;
5. Sistemi i vendbanimeve;
6. Bujqësia.

Ngjyrosja e kutizave të ndërprerjes tregon cili është ndikimi i përfytyruar. Mbizotërimi i ngjyrës së gjelbërt thekson se ndikimet e planit rezultojnë gati ekskluzivisht pozitiv ose potencialisht pozitiv. Për objektiva të veçantë, në lidhje me të cilët shfaqet ngjyra e verdhë, rezulton e nevojshme të monitorohen efektet mjedisore që i referohen zbatimit të veprimeve të veçanta të planit, si përshkruhet në Kapitullin 7.

Analiza nuk evidenton asnje kutizë të ngjyrosur me të kuqe, gjë që tregon se veprimet strategjike të identifikuara nga plani janë të gjitha të orientuara drejt qëndrueshmërisë mjedisore.

	Ndikime pa dyshim pozitive
	Ndikime potencialisht pozitive
	Asnjë ndërveprim
	Ndikime për t'u vlerësuar
	Ndikime potencialisht negative

Në faqen pasardhëse Tabela 4.2 Matrica finale e krahasimit të objektivave kryesorë specifik të planit të Durrësitme kriteret e përgjithshme për realizimin e tij

	KRITERET E PËRGJITHSËM PËR QËNDRUESHMËRI									
	OBJEKTIVAT SPECIFIK TË PLANIT									
	1) Minimizimi i përdorimit të resurseve të paripërtëritshme	2) Përdorimi i resurseve të përtëritshme brenda limiteve të rigjenerimit të mundshëm	3) Shfrytëzimi dhe menaxhimi në mënyrë sa më optimale nën profilin mjedisor i substancave dhe mbetjeve të rrezikshme dhe ndotëse	4) Ruajtja dhe përmirësimi i situatës së florës dhe faunës, natyrave të virgjëra, habitateve dhe peisazheve	5) Ruajtja dhe mirëmbajtja e tokës dhe resurseve hidrike	6) Ruajtja dhe mirëmbajtja e trashëgimisë historike-kulturore	7) Ruajtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit lokal	8) Monitorimi i atmosferës	9) Zhvillimi i kujdesit, edukimi dhe informimi në lidhje me mjedisin	10) Promovimi dhe pjesëmarrja e shoqërisë në vendimmarrjet në lidhje me zhvillimin
1.1 Rritja e kapacitetit të shkarkimeve të Durrësit										
1.2 Mbyllja dhe bonifikimi i shkarkimeve në zonat rurale										
1.3 Realizimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe nxitja e grumbullimit të diferencuar; përmirësimi i efikasitetit të transportimit.										
1.4 Ndarja e mbetjeve organike dhe prodhimi i tyre në kompozit për qëllime ripërdorimi në bujqësinë lokale										
2.1 Zgjerimi i sistemit të centralizuar të shpërndarjes së ujit të pijshëm nëpër fshatra dhe përmirësimi i rrjetit										

OBJEKTIVAT SPECIFIK TË PLANIT	KRITERET E PËRGJITHSËM PËR QËNDRUESHMËRI									
	1) Minimizimi i përdorimit të resurseve të paripërtëritshme	2) Përdorimi i resurseve të përtëritshme brenda limiteve të rigjenerimit të mundshëm	3) Shfrytëzimi dhe menaxhimi në mënyrë sa më optimale nën profilin mjedisor i substancave dhe mbetjeve të rrezikshme dhe ndotëse	4) Ruajtja dhe përmirësimi i situatës së florës dhe faunës, natyrave të virgjëra, habitateve dhe peisazheve	5) Ruajtja dhe mirëmbajtja e tokës dhe resurseve hidrike	6) Ruajtja dhe mirëmbajtja e trashëgimisë historike-kulturore	7) Ruajtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit lokal	8) Monitorimi i atmosferës	9) Zhvillimi i kujdesit, edukimi dhe informimi në lidhje me mjedisin	10) Promovimi dhe pjesëmarrja e shoqërisë në vendimmarrjet në lidhje me zhvillimin
2.2 Përmirësimi i sistemit vaditës në mënyrë që të limitohet fenomeni i ndërhyrjeve të jashtëligjshme në rrjetin e ujit të pijshëm dhe i konsumit të ujërave nëntokësor										
2.3 Ruajtja e ujit të shiut dhe sedimenteve në rrjedhën e sipërme										
2.4 Pastrimi dhe ripërdorimi i sedimenteve										
2.5 Parandalimi i përmbytjeve										
2.6 Sigurimi i strukturave për përforcimin/sisteme mbrojtëse përgjatë Lumit Erzen gjatë zhvillimit të zonave publike në afërsi të tij										
2.7 Menaxhimi i rivierës										
2.8 Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza										
2.9 Futja e mikro-rrjeteve të reja në zona rurale dhe promovimi i sistemeve të trajtimit individual/lokal										
3.1 Rikuperimi i linjës hekurudhore Durrës-Tiranë dhe e stacioneve										
3.2 Rikuperimi i linjës hekurudhore Durrës-Kavajë										
3.3 Zgjatimi i linjës hekurudhore deri në Porto Romano										
3.4 Kompletimi i rrugës së re për në Porto Romano										

OBJEKTIVAT SPECIFIK TË PLANIT	KRITERET E PËRGJITHSËM PËR QËNDRUESHMËRI									
	1) Minimizimi i përdorimit të resurseve të paripërtëritshme	2) Përdorimi i resurseve të përtëritshme brenda limiteve të rigjenerimit të mundshëm	3) Shfrytëzimi dhe menaxhimi në mënyrë sa më optimale nën profilin mjedisor i substancave dhe mbetjeve të rrezikshme dhe ndotëse	4) Ruajtja dhe përmirësimi i situatës së florës dhe faunës, natyrave të virgjëra, habitateve dhe peisazheve	5) Ruajtja dhe mirëmbajtja e tokës dhe resurseve hidrike	6) Ruajtja dhe mirëmbajtja e trashëgimisë historike-kulturore	7) Ruajtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit lokal	8) Monitorimi i atmosferës	9) Zhvillimi i kujdesit, edukimi dhe informimi në lidhje me mjedisin	10) Promovimi dhe pjesëmarrja e shoqërisë në vendimmarrjet në lidhje me zhvillimin
3.4 Realizimi i një unaze të re										
3.5 Realizimi i një porti turistik në Durrës në mënyrë që aktiviteti industrial të përqëndrohet në Porto Romano										
3.6 Modifikimi i hyrjes nga autostrada e Durrësit										
3.7 Sistemimi i akseve rrugore										
3.8 Sistemimi i qarkullimit përgjatë bregdetit										
3.9 Rritja e kapacitetit të stacioneve të autobuzeve										
3.10 Realizimi i qarkullimit pedonal në zona malore/natyrle të mbrojtura										
3.11 Realizimi i një korsie të dedikuar për bicikletat përgjatë Lumit Erzen midis Sukthit dhe Katundit të Ri (Durrës)										
4.1 Realizimi i një zone ekonomike në Durrës										
4.2 Realizimi i strukturave të posaçme për tregtimin e fruta perimeve										
4.3 Instalimi i paneleve fotovoltaike										
5.1 Rikualifikimi i hapësirave të hapura/publike në zonat urbane										
5.2 Rikuperimi i objekteve historike										

<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;">KRITERET E PËRGJITHSËM PËR QËNDRUESHMËRI</div> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto; margin-top: 10px;">OBJEKTIVAT SPECIFIK TË PLANIT</div>	1) Minimizimi i përdorimit të resurseve të përipërtërtshme	2) Përdorimi i resurseve të përtërtshme brenda limiteve të rigjenerimit të mundshëm	3) Shfrytëzimi dhe menaxhimi në mënyrë sa më optimale nën profilin mjedisor i substancave dhe imbetjeve të rrezikshme dhe ndotëse	4) Ruajtja dhe përmirësimi i situatës së florës dhe faunës, natyrave të virgjëra, habitateve dhe peisazheve	5) Ruajtja dhe mirëmbajtja e tokës dhe resurseve hidrike	6) Ruajtja dhe mirëmbajtja e trashëgimisë historike-kulturore	7) Ruajtja dhe rritja e cilësisë së mjedisit lokal	8) Monitorimi i atmosferës	9) Zhvillimi i kujdesit, edukimi dhe informimi në lidhje me mjedisin	10) Promovimi dhe pjesëmarrja e shoqërisë në vendimmarrjet në lidhje me zhvillimin
5.3 Promovimi i edukimit kulturor: shkolla të reja, qendra sociale, shkolla të formimit profesional										
5.4 Realizimi i këndeve të lojrave, kopshte, parqe										
5.5 Zgjerimi/ndërtimi i varrezave										
5.6 Zhvillimi i banesave sociale										
5.7 Lidhja e bregdetit me zonat periferike										
6.1 Promovimi dhe ripërdorimi i taracave malore										
6.2 Ruajtja dhe nxitja e agrikulturës familjare në zonat kodrinore dhe fushore										
6.3 Mbështetja dhe nxitja e strukturave në shërbim të agrikulturës										
6.4 Rregullimi i sistemit të vaditjes dhe drenimit										
6.5 Promovimi i ekonomisë lokale										
6.6 Promovimi i edukimit										
6.7 Promovimi i konsumit të energjisë së rinovueshme										

5 Karakteristikat mjedisore dhe territoriale të Durrësit




Figura 5.1 Harta e shfrytëzimit të territorit 1930 -2015

Rajoni në të cilin ndodhen bashkitë e Durrësit, Shjiakut dhe Vorës paraqet një rast të veçantë duke u konsideruar nga pikëpamja mjedisore, në veçanti Durrësi, i cili është porti kryesor në Shqipëri dhe një nga më të rëndësishmit të detit Adriatik dhe Jon.

Sektorët që kanë pasur ndikimin më negativ në mjedis janë industria e përpunimit të metaleve, ajo kimike, transporti, turizmi dhe bujqësia.

Prandaj, mund të themi se ndotja e mjedisit dhe shterimi i burimeve natyrore janë një rezultat i drejtpërdrejtë i zhvillimeve të fundit socio-ekonomike në rajon si:

- rritja e shpejtë e popullsisë dhe turizmit ka përcaktuar zhvillimet e fundit urbane veçanërisht përgjatë bregdetit dhe, paralelisht, rritja e trafikut automobilistik. Nga njëra anë, është reduktuar ndjeshëm shkalla e ruajtjes në gjendjen natyrale të bregdetit, si pasojë e veprimtarisë së njeriut, nga ana tjetër kemi një rritje në mënyrë eksponenciale në emetimit të CO₂ për shkak të qarkullimit të automjeteve, kryesisht të dorës së dytë të cilat janë shumë ndotëse;
- menaxhimi i keq i mbetjeve dhe mungesa e sistemeve të përshtatshme të kanalizimeve për prurjet e reja të ujërave të zeza komunale kanë shkaktuar ndotje të tokës e të detit, të lumenjve dhe akuiferet. Mungesa e objekteve të deponimit dhe deponive të projektuar rishtazi, si dhe zgjidhja, për fat të keq ende shumë e përhapur, e djegies së mbeturinave ka ngritur problemin e ndotjes së ajrit;
- nxjerrja masive e ujit nga nëntoka për qëllime industriale, bujqësore dhe të banorëve ka varfëruar së tepërmi resurset ujore;
- reduktimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe shpyllëzimi i pakontrolluar kanë pasur një ndikim serioz në habitatet natyrore dhe biodiversitet.

Të gjitha këto çështje janë të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik të zonës. Si rezultat i rënies së regjimit komunist: mungesa e një master plani, dhe legjislacioni që mund të shërbente si rregullator për ndërtimet e reja me qëllimin e ruajtjes së mjedisit, ka sjellë një shtim të zonave të banuara në mënyrë kaotike dhe sjellë si pasojë prishjen e brigjeve.

Një tregues shumë domethënës i evolucionit ekonomik dhe morfologjik të rajonit është ndryshimi në zonat e pyllëzuara që vihet re në hartat e shfrytëzimit të territorit të 1930 dhe 2015 (Figura 5.1): mund të dallohet që ka pasur një zgjerim të qartë të zonave urbane në dëm të zonave të pyllëzuara, të cilat janë pothuajse përgjysmuar me qëllim kthimin e tyre në zona të reja bujqësore, industriale dhe zona urbane.

Formimi i zonës së “Kënetës”, dikur moçalishte, daton që nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, kur regjimi komunist ka përfunduar rehabilitimin e kësaj moçalishte. Në pak vite, ndërmjet 1964-1967, zona ka përfunduar bonifikimin, por pa u shoqëruar me ndërtimin

e çfarëdo lloj infrastrukture urbane (rrugë, furnizim me ujë, kanalizimet dhe kështu me radhë.).

Nga rënia e regjimit komunist, që u konkludua në fillim të viteve '90, erdhi si rezultat hapja e kufijve kombëtarë, kushtet ndryshuan shumë shpejt dhe u vërejt një migrim masiv nga fshati në qytet, i cili rezultoi me një përqëndrim të madh të popullsisë në zonat periferike të Durrësit. Kushtet gjeologjike dhe nevoja për një zgjidhje të menjëhershme strehimi i ka shtyrë banorët e rinj të ndërtojnë objekte emergjente. Këto kasolle (*Kolibe* në gjuhën popullore, kuptimi i parë i fjalës është vendstrehimi i kafshëve), presupozohej të ishin një zgjidhje e përkohshme, por në fakt rezultoi e kundërta. Pushtimi kaloi pa u vënë re deri nga mes i viteve '90.

Parimi i shpërnguljes ishte i thjeshtë: pushtoheshin territoret në rrethinat e qyteteve, jo për çështje komoditeti apo pozicioni, por sepse ishte e thjeshtë lidhja e paligjshme me rrjetin e ujësjellësit, rrjetin elektrik si dhe kanalizimeve të ujërave të zeza. Nga pikëpamja e tipologjisë, ekzistonin vetëm kasollet prej druri, llamarine dhe blloqe betoni të prodhuara në vend në mënyrë artizanale.

Terreni i zaptuar nuk kishte aftësinë mbajtëse për struktura beton-arme dy ose tre katëshe, sepse përbëhej nga dhëra me karakteristika jo të mira fiziko-mekanike. Rëndom ndodhin përmbytje në periudhën e dimrit, si pasojë e mungesës së kapacitetit mbajtës të sistemit të kanalizimeve nga mbipopullimi (shumë kanale janë mbyllur dhe të tjerë të bllokuar duke kompromentuar kështu gjithë sistemin). Zona si Shkozeti, ish zona industriale, dhe Porto Romano, aktualisht porti industrial i qytetit, janë populluar në të njëjtën mënyrë, paçka kanë qenë zona të ndotura.

Me ardhjen e shekullit të ri, në fillimet e viteve 2000, ndodhi një boom i konsiderueshëm ekonomik në të gjithë vendin, i cili ka prekur edhe zonën e Kenetës. Në këtë periudhë vet banorët kanë investuar për ndërtimin e veprave të domosdoshme për evitimin e përmbytjeve dhe përmirësimin e aftësisë mbajtëse të terrenit. Vetëm pas një seri aksionesh të konsiderueshme të lëvizjes së dherave dhe rrenojash u arrit të parandalohen pjesërisht fenomenet e përmbytjeve. Nga ky moment, nëpërmjet fondeve ekonomike të konsiderueshme (është vlerësuar që rreth 98% e investimeve ka ardhur prej emigrimit), filluan të shfaqen shtëpitë e para prej tulle dy ose tre katëshe, të ndërtuara nga vetë pronarët me krah pune lokale me materiale të një cilësie të mirë. Ky fenomen u përhap aq shumë sa 80% e objekteve ka fluar ndërtimin në ato vite. Jo të gjitha janë përfunduar, në fakt, dallohet një numër i madh objektivash të papërfunduara. Themele, karabina prej betoni, struktura të papërfunduara, fitilat e hekurave bashkues të lëna jashtë në fundin e katit të sipërm përfaqësojnë elementët dominues të panoramës urbane, të cilat mund të jenë mjaft tërheqëse si spunto për debat. Paligjshmëria dhe ndërtimi abuziv nuk kanë penguar lindjen e disa rregullave precize që ndiqen në mënyrë të përpiktë nga të gjithë banorët e zonës: një tip pakti efikas informal në përmbajtje që shpesh ligjet kombëtare nuk kanë arritur ta vendosin. Distanca, dimensione, lartësi, orientim hapësinor, të vendosura nga vetë banorët e zonës, të cilat qëndrojnë dhe zbatohen ende sot.

Në vitin 2007 është realizuar një rrugë me nga dy korsi e cila ndan në dy pjesë zonën

e Kënetës. Kjo rrugë, edhe pse e nevojshme për optimizimin e transportit të qytetit ashtu edhe të vetë zonës, është realizuar pranë shtratit të njërit prej kanaleve më të rëndësishëm të sistemit që duhet bonifikuar, duke e nxjerrë atë jashtë funksionit. Pas rreth 20 vjetësh, në 2011, në banesat e zonës së Kënetës erdhi uji i pijshëm, paçka jo në të gjitha zonat e lagjes dhe jo në çdo orë. Në anën tjetër dispozita e përmbushjes së nevojave ujore ngelet një problem i përhapur në të gjithë vendin, duke përmbushur nevojat për vetem 80% të popullsisë, për një mesatare prej 8 orësh në ditë.



Figura 5.2
Kanal kullimi
në zonën e
Kënetës, Durrës

Në paragrafët e mëposhtëm paraqitet një përshkrim i aspekteve mjedisore më të rëndësishme për zonën e Durrësit, që do të shfrytëzohen për zbatimin e planit.

5.1 Ajri

Të dhënat që disponohen për sa i përket cilësisë së ajrit në zonat urbane (cfr. Tabela 5.1), edhe pse jo tërësisht të plota dhe me mangësira kohore, tregojnë se përbërja e grimcave pezull në ajër dhe e pluhurave vijnë kryesisht nga mjetet e transportit dhe nga aktiviteti i industrisë gjë që e bën situatën mjaft shqetësuese dhe alarmante.

Në zonat industriale me ndotje të lartë atmosferike, nuk është parashikuar ende asnjë program monitorimi për cilësinë e ajrit. Shkaktarët kryesorë që sjellin ndotjen atmosferike janë industritë e prodhimit të çelikut, metaleve dhe kromit, nxjerrja dhe përpunimi i hidrokarbureve, centralët hidroelektrike dhe industria e cimentos. Mjetet e transportit, natyrisht, mbeten aktiviteti me ndikim më të lartë në ndotjen e ajrit për zonat urbane.

Në vitet e fundit numri i mjeteve private ka vazhduar të shtohet, dhe duke qenë se mjetet që hyjnë në Shqipëri janë mjete të dorës së dytë ku pjesa më e madhe e tyre është e pajisur me motorra që gjenerojnë ndotje të lartë kjo ka sjellë në mënyrë progresive rritjen e ndotjes atmosferike urbane.

Nga ana tjetër, sektori i ndërtimit po kontribuon ndjeshëm në emetimin e pluhurave, për shkak të mungesës së bashkëpunimit të autoriteteve vendore dhe policisë për zbatimin

e ligjeve që kanë të bëjnë me masat parandaluese të ndotjes.

Mungesa e një rrjeti kombëtar monitorimi për cilësinë e ajrit e bën të pamundur vlerësimin e impaktit të ndotjes atmosferike në shëndetin e njeriut.

Vërehet një ulje e vogël e ndotjes atmosferike në bashkinë e Durrësit këto 10 vitet e fundit, si pasojë e mbylljes së fabrikave që shkaktonin ndotje. Gjithsesi shtimi i trafikut të mjeteve të transportit dhe prodhimi i pluhurave nga kantieret e ndërtimit e mban nivelin e ndotjes atmosferike në vlera shqetësuese.

Nivelet e SO₂, NO₂, LGS dhe CO₂ në atmosferë, Durrës (µg/m³)

Viti	SO ₂	NO ₂	LGS	O ₃	CO ₂
1998	22.5	32	218	21.8	90
2001	23	32	210	25	89
2003	60	60	140	120	-
Norma	50	40	90	120	-

Instat libri vjetor i statistikave, 1991-1999 dhe Ministria e Mjedisit Raporti i gjëndjes së mjedisit 2003

Përqëndrimi i grimcave në mjedis, 2004

Ug/m ³	Tirana					Durrës	Elbasan	Fier	Korça	Shkodra	Vlora	Standati Shqipëri	
SPM	280	233	151	963	219	209	244	468	201	227	117	137	140
PM ₁₀	126	108	67	432	99	95	112	157	88	105	46	56	60

Strategjia kombëtare për mjedisin

Tabela 5.1
Të dhënat për cilësinë e ajrit të Durrësit

5.2 UJI

5.2.1 Ujërat sipërfaqësor

Rrjedhat ujore kryesore në rajonin e Durrës- Tiranë janë lumenjtë Erzen dhe Ishëm. Në zonat fushore dhe në afërsi të grykderdhjeve, këto lumenj paraqiten në një gjendje të mjerueshme për shkak të problemeve nga ndotja mjedisore (Figura 5.3).

Nxjerrja e inerteve nga shtratet e lumenjve nuk kryhet konform standarteve europiane dhe përfaqëson ende sot një nga problematikat më të mëdha mjedisore me pasoja shumë të rënda dhe të parikuperueshme si: ulja e prurjeve të lëndëve të ngurta në grykderdhjet, varfërimi i shtretërve të lumenjve për prodhimin e formacioneve shkëmbore, tërheqja e vijës bregdetare, prerja e shtratit të lumit, rritja e rrezikut ndaj përmytjeve, ulja e nivelit të sipërfaqes së lirë të ujit.

Është evidentuar në dekadat e fundit, përgjithësisht në muajt Maj dhe Dhjetor, një rritje e përmytjeve për shkak të shpyllëzimeve dhe të erozionit, të përshkallëzuara nga një mirëmbajtje e dobët e kanaleve të drenimit dhe të stacioneve të pompimit. Përveç kësaj kontrollat për gjendjen e lumenjve nuk janë të vazhdueshëm ose në disa raste mungojnë tërësisht. Shumë prej rrjedhave ujore dhe kanaleve rrezikojnë zhdukjen e tyre, duke shkakuar kështu një keqfunksionim të sistemeve të vaditjes dhe centraleve hidroenergjitike.

Map 5: Hotspots and Water Pollution in The Region




Figura 5.3
Ndotja e ujit në rajonin Durrës - Tiranë

5.2.2 Ujërat nëntokësor

Ujërat nëntokësor, që përfaqësojnë burimin kryesor të ujit të pijshëm, atë për përdorim industrial si dhe bujqësor, kanë pësuar një degradim të cilësisë së tyre, mbi të gjitha për shkak të zhvillimit demografik dhe industrial në këto rajone.

Përveç kërkesës së lartë për ujë, e cila sëbashku me ndryshimet klimaterike (ulja e sasisë së reshjeve), ka çuar në uljen enivelit të resurseve ujore ekzistuese, ka patur dhe një përdorim të papërgjegjshëm të ujit.

Si impiantet industriale ashtu edhe zonat urbane i shkarkojnë ende sot ujërat e zeza drejtpërdrejt në lumenjtë që përshkojnë territorin, pa një trajtim paraprak të tyre i cili është shumë i limituar (në numër dhe në potencial). Ndotja e ujërave sipërfaqësor reflektohet në cilësinë e ujërave nëntokësor dhe ato detar.

Edhe në ujërat nëntokësor të Durrësit janë hasur vlera të larta të Cl-, K+ dhe jone Na+, që janë tregues të përzierjes së ujërave detar në nivelin e ujërave nëntokësor afër bregdetit.

Burimi kryesor i i shtimit të nivelit të kripërave është urbanizimi i madh i zonës dhe kërkesa e lartë për ujë të ëmbël, si rrjedhojë pompimi i ujit nëntokësor i kalon kapacitetet e rikuperimit të vet akuiferit. Situata aktuale e ujërave nëntokësore matet nëpërmjet puseve të kontrollit të shpërndarë në gjithë territorin.




Figura 5.4
Hartat e shpërndarjes së joneve të Cl-në zonën e Tiranë-Durrës për periudhën a) 1982-2001 b) 2010




Figura 5.5
Harta e shpërndarjes së Na dhe joneve + K ions në zonën Tiranë-Durrës për periudhën a) K 2010 b) Na 2010 c) Na+K 1982-2001




Figura 5.6
Harta e shpërndarjes së TDS për zonën Tiranë-Durrës për periudhën a) 1982-2001 b) 2010

Një shkaktar tjetër i rritjes së nivelit të kripërave është menaxhimi i keq i transportit të fluideve : sedimentet e Lumit Erzen dhe Ishëm përdoren në masë si material për ndërtim në 10 vitet e fundit, për pasojë të kësaj situatë, linja e detit ka avancuar në drejtim të tokës dhe si rrjedhojë ka lehtësuar përzierjen e kripërave.

5.2.3 Ujërat bregdetare

Rritja e qëndrave të banuara dhe zhvillimi i industrisë janë të shoqëruara me rritje të ndotjes së ujit. Derdhjet e mbetjeve urbane dhe ujërat e zeza të sektorit industrial dhe bujqësor, pa asnjë trajtim paraprak janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së ujërave sipërfaqësor. Rezultati i drejtëpërdrejtë i këtij fenomeni është ndotja e detit dhe e zonave bregdetare ku derdhen këto ujëra, sëbashku me aktivitetet e lidhura me portet e ndryshme që përbëjnë një faktor tjetër ndotës përgjatë rivierës.

Një rëndësi shumë të madhe ka monitorimi mikrobiologjik dhe vlerësimi i cilësisë së ujit të bregdetit, duke qenë se kjo uji përdoret edhe për qëllime turizmi. Në veçanti, duke qenë se sektori i turizmit është një nga zinxhirët kryesorë të ekonomisë, duhet vlerësuar me vëmendje të madhe shkalla e rrezikut prej të cilit turistët janë të ekspozuar.

Ujërat në afërsi të bregdetit të Bashkisë Durrës janë ndër më të ndotur në rang vendi: 19% e ujërave janë të kategorisë B (cilësi e mirë), 14 % të kategorisë C (cilësi e dobët), 67% të kategorisë D (cilësi e keqe).



Figura 5.7
Ndotja e bregdetit të Durrësit

5.2.4 Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza

Rrjeti i parë i kanalizimeve të ujërave të zeza në Durrës me gjashtë stacione pompimi përgjatë bregdetit, është realizuar në mesin e viteve ‘70.

Pas afro 50 vjetësh përdorimi dhe mirëmbajtje të ulët ose pa mirëmbajtje fare, rrjeti në vitin 2014 rezultoi të ishte në kushte shumë të këqija, duke kërkuar një ndërhyrje

urgjente për përmirësimin e tij:

- tubacionet beton-arme me gravitet, ishin në gjendje shumë të keqe si pasojë e aktivitetit në masë të ndërtimit pranë plazheve, në shumë pika këto tubacione rezultojnë të shkatëruara ose me humbje apo lidhje të paligjshme në rrjet;
- pusetat, të ndërtuara me materiale të cilësisë së ulët, shpesh nuk kishin as kapakët mbyllës;
- është evidentuar një numër i madh derdhjesh abuzive në rrjetin komunal;
- stacionet e pompimit kishin puse drenimi të ndërtuara me beton-arme tërësisht të shkatëruar, pompa jofunksionale dhe elementët elektrikë të makinerive jo të mbrojtura, duke paraqitur një rrezik për operatorët.

Dy stacionet e para të rrjetit ishin tërësisht jashtë funksionit, si rrjedhojë gjatë fenomeneve meteorologjike i gjithë rrjeti nuk mund të përballonte prurjet, duke shkaktuar kështu përmbytje në zonat e banuara rrishtaz ndihej prania në sipërfaqe të ujërave të zeza. Është evidentuar se stacioni i fundit i rrjetit, në afërsi të portit të Durrësit, shkarkonte në këtë kohë direkt në një kanal në qiell të hapur, ndërsa derdhjet e tjera shkonin dretpërdrejt në det. Mungesa e një sistemi përpunimi i këtyre ujërave para derdhjes së tyre në rrjedhën e lumenjve apo deteve ka sjell ndotjen e ujërave sipërfaqësor.

Si pasojë e gjendjes aktuale të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit të Durrësit, Bashkimi Europian ka akorduar 10 milion euro për rindërtimin dhe rritjen e kapacitetit të këtyre kanalizimeve. Punimet janë përfunduar në vitin 2014 dhe kanë përfshirë:

- instalimi i tubacioneve të reja me një gjatësi në total më shumë se 12.800 m, nga këto 2.800 m gjatësi për zonën e plazhit; dy faktor kanë kushtëzuar më së shumti punimet: nga njëra anë nevojja për të ulur sa më shumë pengesën e qarkullimit në rrugët ku kryheshin ndërhyrje për të mos ndikuar kështu edhe qendrën e qytetit, problematik e zgjidhur nëpërmjet një organizimi të detajuar të të gjitha operacioneve që do të kryheshin në territor si dhe realizimi i gjurmëve vertikale nëpërmjet palankolave dhe mureve mbajtëse; kurse nga ana tjetër niveli i lartë i ujërave nëntokësor, i cili kërkonte realizimin e veprave drenuese;
- realizimi i 290 tombinove me material plastik;
- realizimi i një rrjeti dytësor në shërbim të plazhit, që konsiston në një total prej 2000 m tubacioni i ri;
- realizimi i tre kalimeve rrugore (Ura e Dajlanit) dhe hekurudhore nëpërmjet teknikës “pa-gërmim”(pipe ramming);
- n. 5 ndërlidhje me rrjetin e vjetër të ujërave të zeza, nëpërmjet realizimit të pu-

setave prej beton-armeje;

- rikuperimi i funksionit të stacionit ekzistues n. 5 të pompimit;
- ndërtimi i tre stacioneve të reja pompimi;
- instalimi i pompave në nivel të ujit, centralinave elektrike, transformatorëve dhe grupe për sigurimin e vazhdimësisë për çdo stacion pompimi, me lidhje të reja në rrjetin elektrik dhe kontrollin e automatizuar të funksionimit total;
- realizimi i impiantit të ri për trajtimin e ujërave të zeza, i pari në Shqipëri me “rëra aktive” (Figura 5.8).

Rrjeti i ri i kanalizimeve të ujërave të zeza mbledh derdhjet e të gjithë zonës urbane në afërsi të plazhit deri te impianti i ri i trajtimit të ujërave të zeza (WWTP – WasteWater Treatment Plant). Edhe stacioni i fundit i pompimit i rrjetit të vjetër nuk shkarkon më në një kanal në qiell të hapur por i çon prurjet e tij drejt impiantit. Kjo e fundit përdor metodologji për trajtimin e ujërave të zeza të tipit mekanik (screening, de-sanding) si dhe tipin biologjik, para se të derdhë ujërat në det.



Figura 5.8
Impianti i ri i
pastrimit të
ujërave të zeza
Durrësit

5.3 TOKA

5.3.1 Vulnerabiliteti ndaj erozionit

Erozioni i tokës është një problem që prek gjithë territorin e vendit por në veçanti në zonën Tiranë-Durrës përbën problem edhe më të madh. Siç mund të shihet edhe në Figurën 5.9. ky fenomen manifestohet me shkatërrimin e shkëmbinjve, ku nën ndikimin edhe të shpyllëzimeve të cilat janë përgjegjëse të shkarjeve të dheut, të avancimit së detit, dhe të humbjes së komponentit organik të lëndëve ushqyese prezente në terren. Erozioni është shkaku kryesor i degradimit të tokës duke sjellë: humbjen e lëndëve ushqyese të tokës, që janë thelbësore për kultivimin e kulturave bujqësore, kjo imponon përdorimin e fertilizuesve, që vlerësohen të jenë më shumë se 40% në mënyrë që të

kompensojn humbjet e ushqyesve natyralë të terrenit nga erozioni. Në nivel kombëtar kjo përkthehet në një humbje ekonomike rreth 98 milion dollar.

Map 4: Erosion in the Region




Figura 5.9
Niveli i erozionit në rajonin Durrës - Tiranë

Problemi më i madh në rajonin Durrës – Tiranë është erozioni detar, dinamikat e të cilit janë të përbërë nga faktorë të shumtë si:

- regjimi i valëve detare në gji;
- ndryshimi i funksionit të përdorimit të tokës;
- zhvillimi gjatë kohëve të fundit i aktiviteteve të nxjerrjes së inerteve nga shtratet e lumenjve;
- dinamika morfologjike e periudhës së fundit të pjesës kryesore të shtratit të lumit të marrë në studim.

Erozioni bregdetar ka tre faktor rreziku:

- humbja e zonave me rëndësi ekonomike, sociale apo ekologjike;
- shkatërrimi i pengesave mbrojtëse natyrore (përgjithësisht sistemi i dunave bregdetare) i shoqëruar me katastrofa natyrore, që provokojnë përmbytje të terrenit

në zonat qendrore;

- dobësimi i pengesave mbrojtëse artificiale të bregdetit, duke i ekspozuar terrenet e mbrojtura ndaj rrezikut të përmbytjeve.

Dinamika e morfologjisë të sistemit bregdetar është e kontrolluar kryesisht nga proceset e transportit të sedimenteve në zonën e gjireve, nga veprimi i detit si dhe ujërave që përplasen.




Figura 5.10
Erozioni bregdetar përgjatë gjirit të Lalzit

Në veçanti nxjerrja e inerteve, me pasojë uljen e prurjeve lumore, është shkaktari i avancimit të vijës bregdetare vërejtur që nga rënia e komunizmit në 1991. Përveç kësaj shtimi i veprimtarisë ndërtuese në afërsi të bregdetit, e ka bërë këtë të fundit shumë vulnerabël, duke agravuar një problem ekzistues.

Perceptimi i fenomenit të avancimit të detit nga ana e popullsisë ka filluar rreth mesit të viteve 60. Erozioni i pjesës qendrore të Gjirit të Lalzit, në veri të lumit, filloi të vihej re si një problem i konsiderueshëm vetëm në vitet 70. Më vonë, për shkak të transformimeve të shpejta politiko-sociale si pasojë e rënies së regjimit komunist, që ndodhi në vitet 90 ndodhi shpërngulja masive e banorëve të zonave rurale të cilët braktisën fshatrat kryesisht nga veriu i vendit duke shkaktuar një shpyllëzim masiv.

Në fund të viteve '90 shpyllëzimi arrin deri në afërsi të pishave bregdetare dhe dunat që karakterizojnë plazhet aktive janë rrafshuar për ti hapur rrugën ndërtimit të resorteve dhe plazheve private; në këtë periudhë ka pasur një rritje drastike të fenomenit të erozionit, siç raportohet nga dëshmitë e mbledhura; që nga fillimi i viteve 2000 në këtë zonë




Figura 5.11
Erozioni bregdetar i gjirit të Lalzit, në afërsi të grykëderdhjes së lumit Erzen

ka pasur një rritje të konsiderueshme të intensitetit të batic-zbaticës. Erozioni bregdetar ndikon më shumë në Rrushkull dhe avancimi i detit në drejtim të bregdetit bëhet i qartë nga përmbytja e plotë e tre nga katër radhët e bunkerëve të ndërtuar në breg.

Erozioni bregdetar është i shkaktuar përveç nga veprimtaria e njeriut dhe nga rrymat detare.

Universiteti i Trentos, në bashkëpunim me universitetin e Xhenovës dhe Politeknikun e Tiranës, ka zhvilluar një studim mbi *Erozionin bregdetar në Gjirin e Lalzit, Shqipëri: përshkrim sasior, shkaqet dhe drejtimet e menaxhimit*. Duke u nisur nga parametrat e valëve në thellësi të ujërave bregdetare në këtë studim paraqiten rezultatet e modelimit sipas programit SWAN të sjelljes së rrymave detare nga thellësitë deri në bregun e Gjirit të Lalzit.

Ky lloj studimi i bregdetit, në afërsi të Bashkisë së Durrësit mund të vlerësohet si një shembull që përfaqëson karakteristikat e zonës dhe problematikën e saj.

Nga analizat e kryera rezulton se, pavarësisht se dallgët e thellësisë gjatë dimrit janë më të mëdha, për shkak të drejtimit dhe origjinës së tyre ato gjithsesi pengohen nga Kepi i Bishtit të Pallës, duke ardhur në bregdet të ridimensionuara; e anasjellta ndodh me valët gjatë kohës së verës, drejtimi i avancimit të tyre i bën që mos të hasin në asnjë pengesë duke mos humbur fluksin e energjisë së tyre.

Po nga i njëjti studim evidentohet që është drejtimi i veprimit të valëve në breg dhe jo lartësia e tyre që ka më shumë efekt në bregdet. Analiza në lidhje me këndin e veprimit të valëve lejon të kuptohet tendenca e evoluimit të bregdetit ku vërehet se: valët me origjinë nga P-VP, janë pothuajse tërësisht të perpendicularit me bregun. Dhe si pasojë materiali eroziv nuk transportohet në drejtimin gjatësor me të, por më gjerë. E kundërta ndodh me avancimin e valëve me origjinë J-JP, të cilat vijnë të inklinuara me një kënd rreth 20° me bregun, dhe si pasojë materiali i transportuar shkon në drejtimin V-VL dhe depozitohet në pjesën veriore të gjirit, që është i mbrojtur nga Kepi i Rodonit. E njëjta sjellje do të shfaqet pavarësisht periudhës së kthimit që merret në konsideratë.

Figura 5.11 Erozioni bregdetar i Gjirit të Lalzit, në afërsi të grykëderdhjes së lumit Erzen. Nga analiza e hartës së vulnerabilitetit nga erozioni (Fig. 5.12) evidentohet sesi vlerat më të ulëta i korenspondojnë atyre zonave të pozicionuara në ekstremet e shtrirjes së vijës bregdetare që po studiohet: kjo vërtetohet nga fakti se në të tilla zona largësia e vijës bregdetare është më e madhe në krahasim me ato të zonave qendrore. Çështja ndryshon kur bëhet fjalë për ekspozimin ndaj përmbytjeve (Fig. 5.13): në këtë rast vlerat më të ulëta regjistrohen në zonën qendrore, duke qenë se janë të karakterizuara nga duna të larta, dhe të vështira për tu kapërcyer, ndryshe ndodh me zonat ngjitur, të cilat kanë qenë objekt tjetërsimi për krijimin e plazheve dhe stabilimenteve turistike duke rrafshuar dunat.

Analiza e dinamikës morfologjike të lumit Erzen përbën një element të rëndësishëm të fenomenit të erozionit bregdetar, për shkak se grykëderdhja e tij sjell pjesën më të madhe e sedimenteve lumore në Gjirin e Lalzit. Është e njohur nga studime të shumta se fenomeni i erozionit bregdetar ka një lidhje të drejtëpërdrejtë me prurjet e materialeve të ngurta lumore. Sasia e prurjeve të materialeve të ngurta varet nga faktorë të shumtë, si regjimi hidrogjik, kapaciteti mbajtës i lumit për prodhimin e sedimenteve, morfologjia e shtratit të lumit. Veprimtaria e njeriut që ndërhyr në tjetërsimin e këtyre faktorëve çon në ndryshimin e prurjeve të materialeve të ngurta të vet lumit. Përcaktimi i prurjeve të materialit të ngurtë në rrjedhat ujore është e ndikuar nga faktorë të ndryshëm si dhe nga vlera të lara pasigurish.

Vëllimi mesatar vjetor i derdhjeve të lumit në det vlerësohet të jetë për periudhën para viteve 1991, 4 milion ton/ vit, nga ku 2.77 milion ton të përbëra nga material me dimension më të madh se 0.01mm. Përveç një e dhëne për prurjet vjetore mesatare të së njëjtës periudhë, me vlerë 18 m³/s, nuk janë të disponueshme informacione të tjera domethënëse në lidhje me regjimin hidrogjik, evoluimin morfologjik kohëve të fundit, gjeometrisë së grykëderdhjes, dhe as në lidhje me prodhimin e sedimenteve në shtratit të lumit (informacion, ky i fundit, jo i gjindshëm në shumicën e rasteve).




Figura 5.12
Harta e vlerabilitetit ndaj erozionit, metoda Bosom & Jimenez (2011)

Figura 5.13
Harta e vlerabilitetit ndaj përmytjeve, metoda Bosom & Jimenez (2011)

Në zonën e grykderdhjes është evidente që fenomeni i erozionit është rënduar këto 30 vitet e fundit duke sjellë një avancim të detit nga bregdeti gati 800 m, tregues ky i mungesës së prurjeve lumore.

Nga analiza GIS, zona e gërryer në grykderdhje për dhjetëvjeçarën 75-85 rezulton të jetë $2.88 \times 10^5 \text{ m}^2$, kurse ajo e gërryer gjatë viteve 1985 dhe 2015 është $1.20 \times 10^6 \text{ m}^2$. Këto vlera tregojnë se ndikimi i erozionit në dekadat e fundit ka pësuar rritje me 30%. Kjo lloj rritje nuk mund ti atribuohet vetëm ndryshimit të prurjeve të materialeve të ngurta lumore, por edhe vlerave e tjera të marra, që tregojnë se sedimentet e transportuara nga lumi kanë rënë në dekadat e fundit, duke sjellë një përshpejtim të fenomenit të erozionit përgjatë bregdetit.

5.3.2 Zonat e ndotura

Porto Romano ndodhet 6,5 km në veri të qytetit të Durrësit. Deri në fundin e viteve 1990, kjo zonë ka qenë e njohur për impiantin e prodhimit të bikromat natriumi për lyerjen e lëkurave dhe prodhimin e pesticideve si lindani (γ -HCH) dhe tirami.

